

RAPORT

VLERËSIM I SHPEJTË I NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK TË COVID-19 NË KOSOVË

Qershor 2020

Përmbajtja

| | |
|---|-----------|
| 1. Përmbledhje ekzekutive | 6 |
| 2. Hyrje | 11 |
| 2.1. Rreth Projektit | 12 |
| 2.2. Metodologjia | 13 |
| 3. Gjetjet e hulumtimit | 18 |
| 3.1. Anketa me ekonomi familjare | 19 |
| 3.1.1 Profili i familjeve dhe karakteristikat demografike | 19 |
| 3.1.2 Vetëdijësimi dhe Informimi rreth COVID-19 | 23 |
| 3.1.3 Mësimi në distancë | 25 |
| 3.1.4 Punësimi dhe burimet e jetesës | 27 |
| 3.1.5 Ndarja e punëve të shtëpisë dhe dinamika shoqërore | 42 |
| 3.1.6 Qasja në shërbime bazike dhe Siguria | 45 |
| 3.1.7 Shëndeti seksual dhe riprodhues | 52 |
| 3.2. Anketa me ndërmarrje | 53 |
| 3.2.1 Profili i ndërmarrjeve | 53 |
| 3.2.2 Ndikimi i COVID-19 në ndërmarrje | 55 |
| 3.2.3 Pritjet për të ardhmen | 76 |
| 4. Përfundime | 84 |
| 4.1. Përfundime | 85 |

List of Figuras

| | |
|--|----|
| Figura 1. Gjinia e të anketuarve | 19 |
| Figura 2. Moshë e të anketuarve..... | 19 |
| Figura 3. Vendndodhja e familjeve | 19 |
| Figura 4. Familjet në zonat urbane dhe rurale..... | 20 |
| Figura 5. Niveli i arsimit i të anketuarve..... | 20 |
| Figura 6. Etnia e të anketuarve | 20 |
| Figura 7. Statusi civil i të anketuarve | 20 |
| Figura 8. Përbërja e familjes | 21 |
| Figura 9. Të ardhurat e familjes..... | 21 |
| Figura 10. Ndryshimi i nivelit të të ardhurave pas pandemisë COVID-19..... | 22 |
| Figura 11. Ndryshimi i nivelit të të ardhurave pas pandemisë COVID-19, sipas gjinisë | 22 |
| Figura 12. Sa njerëz me nevoja të veçanta jetojnë në familjen tuaj? | 23 |
| Figura 13. Burimet kryesore të informacionit dhe burimet më të besueshme të informacionit | 23 |
| Figura 14. Burimet kryesore të informacionit dhe burimet më të besueshme të informacionit, sipas përkatësisë etnike | 24 |
| Figura 15. Burimet kryesore të informacionit, sipas moshës | 24 |
| Figura 16. Burimet më të besueshme të informacionit, sipas moshës | 25 |
| Figura 17. Niveli i pajtimit me deklaratën: " Informatat rreth COVID-19 më kanë ndihmuar ta mbroj veten dhe familjen nga virusi" | 25 |
| Figura 18. A ka fëmijë që shkojnë në shkollë në familjen tuaj? | 26 |
| Figura 19. A ishin fëmijët në familje në gjendje të ndiqnin rregullisht mësimin në distancë? | 26 |
| Figura 20. Niveli i pajtimit me deklaratën "Cilësia e arsimit të ofruar përmes mësimëve në distancë ishte e cilësisë së lartë" | 27 |
| Figura 21. Statusi i punësimit para COVID-19, sipas gjinisë..... | 28 |
| Figura 22. Statusi i punësimit para COVID-19, sipas rajonit..... | 29 |
| Figura 23. Statusi i punësimit para COVID-19, sipas përkatësisë etnike..... | 30 |
| Figura 24. Statusi i punësimit para COVID-19, sipas zonës së banimit | 31 |
| Figura 25. Sektori i punësimit, sipas përkatësisë etnike | 31 |
| Figura 26. Sektori i punësimit, sipas rajonit | 31 |
| Figura 27. Sektori i punësimit, sipas gjinisë | 32 |
| Figura 28. Sektori i punësimit, sipas moshës | 32 |
| Figura 29. Industria e punësimit, sipas gjinisë | 33 |
| Figura 30. Ndryshimet në orët kushtuar punës për shkak të pandemisë COVID-19, sipas sektorit të punësimit..... | 33 |
| Figura 31. Ndryshimet në orët kushtuar punës për shkak të pandemisë COVID-19, sipas industrisë të punësimit | 34 |
| Figura 32. Detyrimi për marrjen e pushimit (leje) për shkak të pandemisë, sipas sektorit..... | 35 |
| Figura 33. Ndryshimet në vendin (lokacionin) tipik të punës, sipas gjinisë | 35 |
| Figura 34. Pritjet në lidhje me mundësinë e punësimit pas pandemisë COVID-19..... | 35 |
| Figura 35. Mënyra e marrjes së pagës para COVID-19, sipas zonës së banimit..... | 36 |
| Figura 36. Mënyra e marrjes së pagës para COVID-19, sipas industrisë | 37 |
| Figura 37. Mënyra e marrjes së pagës para COVID-19, sipas gjinisë | 37 |
| Figura 38. Pagesa e kontributeve pensionale para COVID-19, sipas industrisë | 38 |
| Figura 39. Posedimi i sigurimit shëndetësor, sipas gjinisë | 38 |
| Figura 40. A jeni fituesi kryesor i të ardhurave në familjen tuaj?, sipas gjinisë | 39 |
| Figura 41. Sektori i punësimit i fituesit kryesor të të ardhurave, sipas përkatësisë etnike | 39 |
| Figura 42. Industria e punësimit e fituesit kryesor të të ardhurave..... | 40 |
| Figura 43. Si pasojë e COVID19, si janë prekur secila nga burimet (të hyrat) e mëparshme PERSONALE? | 41 |
| Figura 44. A merrni përfitime nga papunësia dhe/ose ndonjë mbështetje financiare nga Qeveria apo komunat që nga përhapja e COVID-19? | 41 |
| Figura 45. A keni marrë ndonjë mbështetje në të mira materiale Qeveria, komunat, OJQ-të, apo organizatat ndërkombëtare që nga përhapja e COVID-19? | 42 |

| | |
|--|----|
| Figura 46. Si pasojë e COVID-19, a ka ndryshuar numri i orëve dedikuar aktiviteteve të mëposhtme? – sipas gjinisë..... | 42 |
| Figura 47. Si pasojë e COVID-19, a ka ndryshuar numri i orëve dedikuar aktiviteteve të mëposhtme? – sipas gjinisë..... | 43 |
| Figura 48. Që nga përhapja e COVID-19, a janë prekur rolet dhe përgjegjësitë tuaja brenda shtëpisë? – sipas gjinisë..... | 44 |
| Figura 49. Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ju personalisht ndonjë nga të mëposhtmet – sipas gjinisë..... | 45 |
| Figura 50 Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ju personalisht ndonjë nga të mëposhtmet – sipas moshës..... | 46 |
| Figura 51. Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ndonjë vështirësi të qasni ndonjë nga shërbimet bazike të radhitura më poshtë: | 47 |
| Figura 52. Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ndonjë vështirësi të qasni ndonjë nga shërbimet bazë të radhitura më poshtë, sipas gjinisë | 48 |
| Figura 53. Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ndonjë vështirësi të qasni ndonjë nga shërbimet bazë të radhitura më poshtë, sipas rajonit..... | 49 |
| Figura 54. Nëse masat kufizuese lidhur me përhapjen e COVID-19 vazhdojnë, çfarë do të ndodhte me situatën tuaj financiare familjare? – sipas përkatësisë etnike | 49 |
| Figura 55. Çështje të ndërlydhura me dhunën në familje..... | 50 |
| Figura 56. A mendoni se ka rritje të dhunës në familje që nga përhapja e COVID-19?, sipas rajonit..... | 51 |
| Figura 57. A dini se ku mund të kërkonti ndihmë dhe mbështetje në rast se dikush përjeton dhunë në familje, sikurse linja telefonike, mbështetje psikologjike dhe policore?, sipas zonës së banimit | 51 |
| Figura 58. Që nga përhapja e COVID19, a keni përjetuar personalisht vështirësi në qasjen në shërbimet e mëposhtme të shëndetit seksual dhe riprodhues dhe kontrceptiv për vetveten, partnerin tuaj ose anëtar tjetër të familjes?..... | 52 |
| Figura 59. Që nga përhapja e COVID19, a keni përjetuar personalisht vështirësi në qasjen në shërbimet e mëposhtme të shëndetit seksual dhe riprodhues dhe kontrceptiv për vetveten, partnerin tuaj ose anëtar tjetër të familjes?..... | 53 |
| Figura 60. Ndarja e ndërmarrjeve sipas rajonit..... | 54 |
| Figura 61. Madhësia e ndërmarrjeve | 54 |
| Figura 62. Statusi ligjor i ndërmarrjeve..... | 54 |
| Figura 63. Vitet në treg të ndërmarrjeve..... | 54 |
| Figura 64. Ndarja e ndërmarrjeve sipas sektorit | 55 |
| Figura 65. Ndërmarrjet eksportuese..... | 55 |
| Figura 66. Si do ta përshkruanit performancën financiare të kompanisë suaj para COVID-19?..... | 56 |
| Figura 67. Cili është burimi juaj kryesor i informacionit në lidhje me COVID-19 (rreziqet, veprimet e rekomanduara parandaluese, strategjitë e përballimit)?..... | 57 |
| Figura 68. Sa i mbështesni masat aktuale të qeverisë për të mbyllur/kufizuar veprimtarinë e bizneseve në mënyrë që të ngadalësohet përhapja e COVID-19?..... | 58 |
| Figura 69. Në përgjithësi, si do ta vlerësonit ndikimin e situatës COVID-19 për biznesin tuaj? | 59 |
| Figura 70. Arsyet për ndikim shumë negativ dhe negativ | 60 |
| Figura 71. A është dashur që biznesi juaj të ndalojë aktivitetin (qoftë tërësisht apo pjesërisht) për shkak të situatës COVID-19?..... | 61 |
| Figura 72. Cila është arsyeja KRYESORE për shkak të cilës keni ndaluar aktivitetin tuaj? (vetëm ato që kanë ndaluar aktivitetin) | 62 |
| Figura 73. A e keni ndaluar aktivitetin e biznesit para se qeveria të shpallte masat kufizuese? | 63 |
| Figura 74. Duke marrë parasysh se kjo situatë mund të zgjasë më shumë se një muaj, a po bëni ndonjë përpjekje për të filluar përsëri zhvillimin e biznesit gjatë pandemisë/karantinës? | 64 |
| Figura 75. Që kur ndaluar aktivitetin e biznesit, ju jeni: | 65 |
| Figura 76. A vazhdon kompania juaj të paguajë kontribute pensionale për punonjësit e saj si para përhapjes së COVID - 19? | 66 |
| Figura 77. A ka dhënë dorëheqje nga puna ndonjë punonjës? | 67 |

| | |
|---|----|
| Figura 78. Cila nga më të mëposhtmet vlen në rastin tuaj? | 68 |
| Figura 79. Cila nga më poshtë është problem për kompaninë tuaj duke pasur parasysh situatën aktuale me COVID-19? | 69 |
| Figura 80. Nëse COVID-19 vazhdon të përhapet gjatë dy-tre muajve të ardhshëm, cili nga këto do të ishte shqetësimi kryesor për biznesin tuaj? | 70 |
| Figura 81. A është dashur që biznesi juaj të zvogëlojë fuqinë punëtore për shkak të situatës aktuale? | 70 |
| Figura 82. Cilat nga çështjet e mëposhtme ju detyruan të mbyllni aktivitetin e biznesit? (Pyetje me shumë përgjigje) | 71 |
| Figura 83. A është dashur që biznesi juaj të marrë masa të tjera për punonjësit? Cilat nga të mëposhtmet vlen? | 72 |
| Figura 84. Ndikimi në të ardhura, shpenzime, shitje dhe inventar | 73 |
| Figura 85. A po konsideron biznesi juaj të marrë një kredi për t'u përballuar me efektet aktuale të situatës me COVID-19? | 74 |
| Figura 86. Nëse jo, cila është arsyeja kryesore? | 75 |
| Figura 87. Duke marrë parasysh të gjitha, edhe sa kohë mendoni se biznesi juaj mund ta përballojë këtë situatë? | 76 |
| Figura 88. Sa kanë ndikuar masat e mëposhtme qeveritare në biznesin tuaj? | 77 |
| Figura 89. Cili do të ishte sugjerimi juaj për qeverinë për masat që mund të ndihmojnë llojin e biznesit tuaj për t'u përballur me situatën? | 78 |
| Figura 90. Cili do të ishte sugjerimi juaj për organizatat ndërkombëtare për masat që mund të ndihmojnë llojin e biznesit tuaj për t'u përballur me situatën? | 79 |
| Figura 91. A keni pasur ndonjë plan për investime, përpara situatës me COVID-19? | 80 |
| Figura 92. A kanë ndryshuar këto plane për shkak të situatës? (Vetëm ata që kanë pasur plane investimi) | 81 |
| Figura 93. A shihni ndonjë mundësi të re për biznesin tuaj për shkak të COVID-19? | 82 |
| Figura 94. Në përgjithësi, kur mendoni se Kosova do të rikthehet në jetën normale? | 83 |

1. Përmbledhje ekzekutive

Deklaratë për mospranimin e përgjegjësisë

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të të anketuarve që morën pjesë në Anketën me Ekonomi Familjare si dhe në Anketën me Ndërmarrje në Kosovë, dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP, UNFPA ose UN Women.

Përhapja e koronavirusit COVID-19 ka ndikuar familjet dhe ndërmarrjet në Kosovë¹ në aspekte të ndryshme, përfshirë mënyrën se si ato ballafaqohen me mundësinë e kontraktimit të virusit; si kujdesen për shëndetin e tyre ose shëndetin e punonjësve të tyre; si dhe nëse janë duke bërë biznes ose duke punuar; si dhe çfarë blejnë, shesin ose prodhojnë. Qeveritë anembanë botës kanë pasur qasje të ndryshme në luftimin e pandemisë së koronavirusit të cilat kanë sjellë rezultate të ndryshme. Përveç që shkatërrimi i ka kapluar të gjitha vendet e botës dhe ua ka ndryshuar tërë rrjedhën e tyre të veprimit, njerëzit, ndërmarrjet dhe institucionet është dashur të përshtaten me realitetin e ri të pasigurt, i cili tani po analizohet, duke qenë të vetëdijshëm se ndikimi i plotë ende nuk është kuptuar tërësisht.

Institucionet e Kosovës kanë vendosur një sërë masash që nga 13 marsi 2020 kur karantinuan komunitetet e Klinës dhe Vitisë ku u konfirmuan rastet e para me koronavirus; mbyllën transportin ndër-urban dhe kufijtë tokësor për qytetarët jo-kosovarë dhe vendosën një karantinë dy-javore për të gjithë qytetarët që hyjnë në Kosovë.² Me kohë, institucionet e Kosovës u përshtatën me zhvillimet e reja duke vendosur karantina të tjera në baza komunale; ndaluan tërësisht veprimtarinë ekonomike përveç të punëtorëve esencialë; zbutën masat; ofruan ndihmë financiare për njerëzit që humbën punën e tyre dhe për ata që punonin pa rrogë; ofruan ndihmë për ndërmarrjet me pagesën e qirasë, shtyrjen e deklarimit dhe pagesën e tatimeve; shtyrjen e pagesës së interesit në kredi, etj.

Për të kuptuar ndikimin në ekonomi familjare dhe ndërmarrje, Ekipi i Kombeve të Bashkuara për Kosovën (UNKT), konkretisht Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Enti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsi (UNFPA), vendosën të bëjnë një vlerësim të shpejtë mbi ndikimin socio-ekonomik të pandemisë COVID-19 dhe efektivitetin e masave reaguese të menjëhershme.

Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësojë me shpejtësi ndikimin e pandemisë COVID-19 në ekonomi familjare dhe ndërmarrje dhe të kuptojë se në cilat fusha duhet të përqëndrohet ndihma për individët, familjet dhe ndërmarrjet. Disa nga gjetjet kryesore në lidhje me informimin rreth COVID-19, punësimin dhe veprimtarinë e ndërmarrjeve, ndryshimet e të ardhurave personale dhe të ndërmarrjeve, qasjen në shërbime bazike, mekanizmat e ballafaqimit si dhe pikëpamjet mbi të ardhmen janë paraqitur më poshtë.³

Anketat me ekonomi familjare dhe ndërmarrje u përqëndruan së pari në të kuptuarit se ku, të dy palët, mbështeten për t'u **informuar rreth COVID-19** për të kuptuar, parandaluar dhe mbrojtur vetveten, anëtarët e familjes ose punonjësit e tyre. Në përgjithësi, qytetarët e Kosovës informoheshin kryesisht në radio, televizion dhe gazetë (89%), internet dhe rrjete sociale (74%) për të marrë informata rreth COVID-19. Në të njëjtën kohë, rreth 64% e bizneseve përdornin internetin dhe rrjetet sociale si kanal kryesor për të marrë informata rreth rreziqeve të ndërlidhura me COVID-19, veprimeve parandaluese të rekomanduara si dhe strategjive të ballafaqimit me të.

Në vlerësimin e ndikimit të COVID-19 ndaj qasjes së fëmijëve në **mësimin në distancë**, shumica e fëmijëve të familjeve të intervistuar ishin në gjendje të ndjekin mësimin në distancë rregullisht (96%), ndërsa vetëm rreth 4% e tyre i humbën mësimet dhe më së shpeshti për shkak që pajisjet përdorshin nga disa anëtarë të tjerë të familjes ose problemeve me lidhjen në internet. Një pjesë e këtyre të anketuarve përmendën që disa fëmijë humbën mësimin në distancë për shkak se mësuesit që nuk e mbanin orën

¹ Referencat për Kosovën duhet të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999)

² Qeveria e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. Vendim për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me koronavirus Covid-19 <<https://bit.ly/2Lzg2iB>>

³ Ka një zbatueshmëri të kufizuar të krahasimeve në mes të dhënave të Pulsit Publik 2020 dhe këtij studimi, për shkak të dallimeve në metodologji, formulimit të ndryshëm të pyetjeve dhe opsioneve të përgjigjeve, si dhe kohës së mbledhjes së të dhënave

mësimore ose për shkak të cilësisë së mësimave. Mesatarisht, të anketuarit u pajtuan se cilësia e mësimit në distancë ishte mjaft e mirë, me një rezultat 3.8 nga 5.

Në vlerësimin e statusit të punësimit të të anketuarve dhe të fituesve kryesorë të të ardhurave në familje, shumica e burrave (54%) dhe 29% e grave kanë qenë të punësuar të paktën një javë para përhapjes së pandemisë COVID-19. Pas përhapjes së COVID-19 në Kosovë*, rreth 40% e të punësuarve kanë qenë në gjendje të mbajnë vendin e tyre të punës, por gjatë karantinës nuk ishin duke punuar fare, ndërsa 22% thonë se kanë zvogëluar orët kushtuar punës me pagë. Rreth një e pesta e të anketuarve raportojnë se ata vazhduan të punojnë po aq orë pune si përpara pandemisë (22%). Vetëm 8% e të anketuarve humbën punën për shkak të COVID-19. Duhet të theksohet se humbja më e madhe e vendeve të punës u pa në sektorin e ndërtimitarisë (23%) dhe sektorin e ushqimit dhe akomodimit (mikpritjes) (14%), dy sektorë ku punojnë rreth një e pesta e fituesve kryesorë të të ardhurave në familje.

Sa i përket **veprimtarisë së ndërmarrjeve**, shumë ndërmarrje (56%) duhej të mbylleshin, dhe disa (31%) punonin me kapacitet më të ulët, ndërsa vetëm 13% funksiononin si zakonisht.

Lidhur me këtë, ndërmarrjet u pyetën edhe për punësimin e stafit të tyre pas COVID-19, ku ata që nuk e ndalën plotësisht funksionimin e tyre (11%) deklaruan se duhej të zvogëlonin stafin. Sidoqoftë, sa më e madhe ndërmarrja, aq më shumë gjasa që fuqia punëtore duhej të zvogëlohej. Përafërsisht 40% e ndërmarrjeve të mesme (më shumë se 50 të punësuar) zvogëluan stafin e tyre për shkak të pandemisë.

Shumica e ndërmarrjeve ndaluan aktivitetin e tyre për shkak të masave të qeverisë (81%), por gjithashtu për shkak të mungesës së klientëve (24%) dhe problemeve me pagesë të pagave (16%). Megjithatë, rreth 60% e bizneseve mbështesin deri diku masat e vendosura të qeverisë.

Rreth gjysma e **familjeve** (49%) pësuan një rënie të të ardhurave për shkak të pandemisë, ndërsa 44% deklaruan se të ardhurat e tyre familjare nuk kanë ndryshuar. Edhe ndërmarrjet kishin probleme me nivelet e të ardhurave pasi 63% raportuan rënie të tyre. Për më tepër, më shumë se gjysma e bizneseve (56%) raportuan rënie në shitje dhe shpenzime.

Duke vlerësuar ndryshimet **në vendin fizik të punës**, 27% e individëve punonin nga shtëpia gjatë karantinës. Ndërsa janë vetëm rreth 15% e ndërmarrjeve që deklaruan se lejuan punonjësit e tyre të punonin nga shtëpia.

Në nivel individual, 28% e të anketuarve përjetuan efekte në shëndetin e tyre psikologjik, mendor ose emocional për shkak të pandemisë. Grupi më i prekur duket se janë personat e moshës 25-44 vjeç. Ndërsa, për sa i përket rajonit, Gjakova (53%) dhe Prizreni (46%) raportuan ndikimin më të madh në shëndetin e tyre psikologjik, mendor ose emocional. Sa i përket **ndarjes së punëve të shtëpisë dhe dinamikës shoqërore**, koha e kaluar e grave duke bërë punë shtëpiake të papaguara është rritur shumë më tepër se ajo e burrave. Gratë i kushtuan më shumë orë (57%) pastrimit pas shpërthimit të COVID-19 sesa burrat (39%). Për më tepër, 56% e grave dhe 27% e burrave deklaruan se i kanë kushtuar më shumë orë gatimit dhe shërbimit të shujtave. Përveç kësaj, gratë (37%) gjithashtu kanë kaluar më shumë kohë me fëmijët përmes lojërave, leximit dhe diskutimeve, krahasuar me burrat (29%).

Më shumë se gjysma e të anketuarve deklaruan se kishin hasur në vështirësi në qasjen e një sërë shërbimesh bazike sociale dhe shëndetësore. Rreth 50% e të anketuarve pohuan se kishin probleme me sigurimin e ushqimit dhe madje edhe më shumë kishin vështirësi në sigurimin e pajisjeve mjekësore për mbrojtje personale (56%). Më shumë se 30% kishin vështirësi për të siguruar produkte higjienike dhe sanitare dhe rreth 20% e të anketuarve kishin vështirësi në qasjen në shërbimet shëndetësore dhe ndihmën sociale. Për

sa i përket dallimeve gjinore, 53% e grave dhe 46% e burrave kanë pasur vështirësi në qasjen në ushqim dhe 57% të grave dhe 51% të burrave kanë pasur vështirësi në furnizime me pajisje për mbrojtje personale.

Më shumë se 50% e të anketuarve mendojnë se ka një rritje të **dhunës në familje** që nga fillimi i përhapjes së COVID-19. Të anketuarit nga Mitrovica (79%) përbënin numrin më të madh të atyre që besojnë se dhuna në familje është rritur. Një numër më i madh i të rinjve (57%), i individëve që jetojnë në zona urbane (61%), si dhe i të anketuarve serbë (68%) në krahasim me grupet e tyre të referimit raportuan se besojnë që ka një rritje të dhunës në familje. Sidoqoftë është shqetësuese që 35% e të anketuarve nuk dinë ku të kërkojnë ndihmë në rast të dhunës në familje.

Nëse **masat e ndërlydhura me koronavirusin** do të vazhdonin, shumë (59%) të anketuar kishin frikë se do të ishte e vështirë të mbulonin shpenzimet bazike, dhe rreth gjysma e të anketuarve do t'u drejtoheshin për ndihmë qeverisë lokale ose familjes dhe miqve dhe deklaruan se do të ishte vështirë të paguanin qiranë. Në anën tjetër, rreth **një e treta e ndërmarrjeve ishin të pasigurt se për edhe sa kohë do të mund të përballonin situatën aktuale** me koronavirus. Vetëm pak më shumë se një e katërta e ndërmarrjeve kanë pohuar se ata nuk po konsideronin marrjen e një kredie për shkak të normave të pafavorshme të interesit (për ndërmarrjet e vogla dhe të vogla) dhe për shkak të mos pasurit nevojë për të (për ndërmarrjet e mesme).

Sa i përket **përfitimeve nga papunësia ose mbështetjes tjetër financiare nga qeveria ose komunat**, vetëm 3% e atyre që kanë humbur vendin e punës raportuan se kanë marrë përfitime të papunësisë nga qeveria, dhe 2% se kanë marrë ndihmë financiare nga komuna.

Rreth 35% e bizneseve kishin **plane për investime** para pandemisë COVID-19, por 84% e tyre kanë ndryshuar planet e tyre dhe nuk po investojnë për shkak të situatës aktuale. Pothuajse asnjë nga ndërmarrjet e anketuara nuk shohin mundësi të reja biznesi si rezultat i COVID-19.

Shumica e ndërmarrjeve nuk kishin ndonjë sugjerim për qeverinë, por ata që kishin, sugjeruan mbështetje financiare dhe lirim, jo shtyrje, të detyrimeve tatimore. Ndërsa, të njejtat sugjeruan që organizatat ndërkombëtare të ofrojnë ndihmë financiare përmes granteve për ndërmarrje dhe të japin këshilla për qeverinë se si të merren me pasojat ekonomike.

2. Hyrje

2.1. Rreth Projektit

Pandemia e COVID-19 ka çuar në marrjen e masave të rrepta nga institucionet e Kosovës për të parandaluar përhapjen e virusit. Disa nga masat përfshijnë mbylljen e të gjitha institucioneve arsimore publike dhe private, mbylljen graduale fizike të të gjitha ndërmarrjeve që merren me tregti me pakicë, të industrisë së ushqimit dhe shërbimeve, anulimin e të gjitha fluturimeve dhe mbylljen e të gjithë kufijve tokësorë. Masa e fundit e ndërmarrë ishte kufizimi i lëvizjes së qytetarëve dhe makinave private brenda afateve kohore specifike. Kriza pritet të ketë ndikime të mëdha sociale dhe ekonomike, pasi industria e shërbimeve dhe tregtia janë goditur ndjeshëm. Institucionet qendrore kanë ndërmarrë masa për të mbështetur bizneset përfshirë propozimin e një pakoje të stimulimit fiskal prej 170 milion Eurosh për të mbështetur rimëkëmbjen e sektorëve privat dhe publik nga kriza.

Ndërsa kriza shpërndahet dhe varësisht nga kohëzgjatja e saj, implikimet sociale dhe ekonomike do të jenë domethënëse. Ndikimi do të varet nga rritja e papunësisë, varfëria e thelluar, humbja e të ardhurave, pasiguria e vendeve të punës, pabarazitë specifike të industrive, deri te ngecja në arsim e ngecja në përpjekjet për të zvogëluar hendekun gjinor në Kosovë.

Sfidat do të jenë veçanërisht të rënda për familjet në nevojë, të cilët jetojnë me burime të ardhurash të përditshme. Një vlerësim i shpejtë i ndikimit socio-ekonomik të COVID-19 është pra i rëndësishëm për të kuptuar shtrirjen dhe dallimin e ndikimeve sistematike të krizës, ndikimin e tij në grupet e varfra dhe të cenueshme si dhe në ekonominë lokale. Studimi përdor një qasje të kombinuar për të arritur grupet e cenueshme dhe ekonominë lokale dhe përfshin:

1. Vlerësim të shpejtë të ndikimit socio-ekonomik të krizës në familjet kosovare, me fokus të veçantë në grupet e cenueshme (d.m.th. humbjet financiare, efekti i karantinës në dinamikën sociale, barra në arsim dhe hendeku gjinor, etj.).
2. Vlerësim të ndikimit afatshkurtër në performancën e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, humbjet e mundësive biznesore dhe nevojat e rimëkëmbjes së ndërmarrjeve.

Gjetjet e këtij raporti identifikojnë nevojat dhe e bëjnë të mundshme mbështetjen e synuar nga autoritetet qendrore dhe lokale, si dhe partnerët e zhvillimit, për të zbutur ndikimin e krizës dhe për të rritur adaptueshmërinë e qytetarëve.

Qëllimi i këtij studimi dhe raporti është të përcaktojë natyrën dhe nivelin e ndikimit sistematik të krizës COVID-19 dhe të identifikojë shtrirjen, intensitetin dhe kërcënimin e tij për grupet e cenueshme dhe ekonominë lokale. Kështu, vlerësimi synon të analizojë ndikimin socio-ekonomik të krizës duke përdorur një grup të dhënash primare nga (1) familjet kosovare dhe (2) ndërmarrjet lokale, dhe në fund të bëjë rekomandime që mbulojnë mbështetje afatshkurtër dhe afatmesme nga qeveria dhe partnerët e zhvillimit. Zhvillimi i anketës për familjet u bazua në mjetin e shpejtë të vlerësimit gjinor të UN Women.

Vlerësimi është i shpejtë në realizim për të mundësuar hartimin dhe vendosjen e masave reaguese për të zvogëluar ndikimin negativ për familjet dhe ndërmarrjet. Gjetjet e hulumtimit mundësojnë që të kuptohet më mirë se kush u ndikua më tepër, llojin e burimeve të nevojshme, si dhe fokusimin në boshllëqet e identifikuar në qasjen dhe dhënien e shërbimeve.

2.2. Metodologjia

Në mënyrë që të shqyrtohet ndikimi i COVID-19 te qytetarët, me fokus të veçantë te grupet e cenueshme, si dhe tendërmarrjet në Kosovë, UNDP ka porositur IDRA Research and Consulting në Kosovë që të kryejë dy anketa me mostrat si më poshtë:

1. Anketa me ekonomi familjare, N=1,412 intervista
2. Anketa me ndërmarrje, N=202 intervista

Anketa me ekonomi familjare

Mbledhja e të dhënave për anketën me ekonomi familjare u krye me metodën CATI (Intervistë Telefonike e Asistuar nga Komputeri). Një sistem i cili gjeneron rastësisht numra të telefonave mobil është përdorur si hap i parë i përzgjedhjes së anketuarve. Sistemi ka algoritme “të integruara” që zbulojnë segmentet e numrave mobil që janë në përdorim bazuar në informatat e dhëna nga operatori kur numri i gjeneruar në mënyrë të rastësishme del se nuk ekziston. Përgjatë viteve të funksionimit të sistemit, informatat vazhdimisht janë shtuar në databazë sa i përket vendndodhjes gjeografike të numrave që janë thirrur për hulumtime në të kaluarën. Prandaj ekziston mundësia që të parashikohet "vendndodhja" e numrit që do të thirret pasi të gjenerohet. Ky mjet siguron që kontaktet gjenerohen në mënyrë të rastësishme.

Pas gjenerimit të numrave, një pyetësor shqyrtues është përdorur për të përcaktuar nëse të anketuarit janë të përshtatshëm sipas kërkesave të mostrës:

- Vendndodhja (komuna)
- Zona e banimit: Urban/Rural
- Moshë
- Gjinia
- Niveli i arsimit
- Statusi i punësimit

Pasi u kontrollua dhe verifikua kuota, atëherë u bë intervista kryesore. Intervistat për Anketën me Ekonomi Familjare janë realizuar nga 1 maji deri më 9 maj 2020. Ndërsa intervistat për Anketën me Ndërmarrje janë realizuar nga 1 maji deri më 8 maj 2020. Procesi i shqyrtimit ndihmon monitorimin e fazës së mbledhjes së të dhënave, pasi siguron që secila intervistë e kryer të përshtatet me shpërndarjen e planifikuar të intervistave.

Shpërndarja e mostrës

Shpërndarja e intervistave bazohet në të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Përqindjet në tabelë që tregojnë përqindjen e popullsisë (mbi 18 vjeç) janë marrë nga të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2011. Gjithashtu, lloji i vendbanimit, gjinia dhe shpërndarja e moshës u bazua në të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë 2011, siç vërehet në tabelat më poshtë.

Bazuar në këto të dhëna, intervistat për çdo rajon janë paraparë si më poshtë:

Tabela 1. Shpërndarja e mostrës sipas rajonit

| Rajoni | Përqindja | Intervista |
|--------------------|-------------|--------------|
| Gjakovë | 11% | 152 |
| Prishtinë/Priština | 27% | 382 |
| Gjilan | 10% | 143 |
| Prizren | 17% | 246 |
| Pejë | 10% | 132 |
| Ferizaj | 10% | 139 |
| Mitrovicë | 15% | 218 |
| Total | 100% | 1,412 |

Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas zonës së banimit

| Zona e banimit | Përqindja | Intervista |
|----------------|-------------|--------------|
| Rural | 55% | 783 |
| Urban | 45% | 629 |
| Total | 100% | 1,412 |

Tabela 3. Shpërndarja e mostrës sipas gjinisë

| Gjinia | Përqindja | Intervista |
|--------------|-------------|--------------|
| Gra | 50% | 704 |
| Burra | 50% | 708 |
| Total | 100% | 1,412 |

Tabela 4. Shpërndarja e mostrës sipas moshës

| Mosha | Përqindja | Intervista |
|--------------|-------------|--------------|
| 18-24 | 19% | 274 |
| 25-34 | 25% | 348 |
| 35-44 | 21% | 292 |
| 45-54 | 16% | 222 |
| 55-64 | 10% | 142 |
| 65+ | 10% | 134 |
| Total | 100% | 1,412 |

Procesi i mbledhjes së të dhënave u monitorua nga afër për të arritur një shpërndarje të mjaftueshme në lidhje me statusin e punësimit pasi që të papunët perceptohen një grup veçanërisht i prekshëm. Tabelat e mëposhtme tregojnë llogaritjet për numrin e intervistave.

Tabela 5. Shpërndarja e mostrës sipas statusit të punësimit

| Statusi i punësimit | Përqindja | Intervista |
|--|-------------|--------------|
| Të vetë-punësuar | 10% | 139 |
| Kontribuues në biznes familjar (pa pagesë) | 1% | 10 |
| Të punësuar | 41% | 583 |
| Të papunë | 10% | 141 |
| Nxënës, studentë, duke ndjekur trajnime të mëtejshme, praktikë pa pagesë | 5% | 72 |
| Në pension ose pension të parakohshëm, ose ka hequr dorë nga biznesi | 10% | 143 |
| Me aftësi të kufizuara të përhershme | 1% | 7 |
| Të angazhuar me punë shtëpiake | 10% | 148 |
| Të dekurajuar/jo-aktivë të tjerë | 12% | 169 |
| Total | 100% | 1,412 |

Marzhi i gabimit për një mostër totale prej 1,412 intervistash në Kosovë llogaritet të jetë $\pm 2.6\%$.

Anketa me ndërmarrje

Një anketë u realizua edhe me 202 ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme. Mbledhja e të dhënave u realizua gjithashtu me metodën CATI (Intervistë Telefonike e Asistuar nga Komputeri).

Një procedurë e marrjes së mostrave shumë-fazore është përdorur për të identifikuar bizneset e përshtatshme. Bizneset janë identifikuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), përmes informatave të mëposhtme:

- 1) NIPT (ekuivalent me numrin e identifikimit tatimor)
- 2) Emri i biznesit
- 3) Data e regjistrimit
- 4) Lloji i Ndërmarrjes (shpk, SH.A., Person fizik, etj.)
- 5) Adresa
- 6) Kapitali Fillestar
- 7) Përfaqësuesi Ligjor
- 8) Statusi (aktiv, pasiv, nën falimentim)

Bazuar në këtë databazë, ndërmarrjet janë zgjedhur rastësisht sipas vendndodhjes dhe më pas kanë kaluar përmes një procedure shqyrtimi e cila është si më poshtë:

1. Kontaktohet ndërmarrja (duke përdorur kontakte nga databaza të ndryshme, ekstrakte nga këshilli kombëtar për kërkim, oda ekonomike, faqet e verdha, etj.)
2. Shqyrtimi (Vlerësimi) i ndërmarrjes (përmes një mini anketeje përmes telefonit) lidhur me:
 - a. Madhësinë
 - b. Rajonin
3. Nëse ndërmarrja i përshtatej kuotës, (kuota ndërlidhëse - rajoni, madhësia, pronësia), atëherë u caktua një takim për pyetësorin kryesor.

Duhet theksuar se sektori i biznesit i Kosovës është i përbërë pothuajse tërësisht nga NMVM-të (ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme). Ka rreth 38,000 ndërmarrje të regjistruara që operojnë në Kosovë:

- 93.1% e të cilave janë ndërmarrje mikro,
- 5.9% janë të vogla dhe
- 0.9% janë të mesme.
- Vetëm 0.1% e popullsisë së përgjithshme të ndërmarrjeve klasifikohen si ndërmarrje të mëdha.

Klasifikimi i NVMV-ve në Kosovë përcaktohet me ligjin për investimet e huaja, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2014. Sa i përket shpërndarjes gjeografike të ndërmarrjeve, rreth një e treta e të gjitha ndërmarrjeve të regjistruara janë të vendosura në rajonin e Prishtinës. Më poshtë është shpërndarja e bizneseve në Kosovë, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (2018).

Table 6. Shpërndarja e ndërmarrjeve në Kosovë

| Rajoni | Mikro (1-9) | Të vogla (10-49) | Të mesme (50-249) | Të mëdha (250+) | Total | Përqindja |
|---------------|---------------|------------------|-------------------|-----------------|---------------|-------------|
| Gjakovë | 3,408 | 162 | 17 | 2 | 3,589 | 9% |
| Gjilan | 3,580 | 233 | 20 | 0 | 3,833 | 10% |
| Mitrovicë | 3,069 | 146 | 23 | 2 | 3,240 | 8% |
| Pejë | 3,189 | 185 | 23 | 2 | 3,399 | 9% |
| Prizren | 5,625 | 317 | 34 | 3 | 5,979 | 16% |
| Prishtinë | 12,605 | 1,111 | 216 | 47 | 13,979 | 37% |
| Ferizaj | 3,898 | 231 | 28 | 1 | 4,158 | 11% |
| Kosovë | 35,374 | 2,385 | 361 | 57 | 38,177 | 100% |

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018

Siç ilustron nga tabelat e mësipërme dhe ajo më poshtë, nëse shpërndarja e mostrës do bazohej në të dhënat zyrtare, atëherë nuk do të ishte e mundur të analizohen të dhënat sipas segmentit të ndërmarrjes (mikro, të vogla dhe të mesme) për shkak të një numri shumë të vogël të intervistave për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në mënyrë proporcionale. Prandaj, për të pasqyruar me saktësi shtrirjen e bizneseve në Kosovë, kuotat dhe peshat e mëposhtme janë aplikuar për mostrën e anketës me ndërmarrje. Përveç madhësisë së ndërmarrjes, kuotat u zbatuan për shpërndarjen rajonale, si dhe për aktivitetin ose industrinë kryesore të biznesit. Mostra sipas kuotave mundëson analizimin dhe ofrimin e gjetjeve për të tre segmentet e ndërmarrjeve veç e veç. Prandaj, në këtë raport, rezultatet e përgjithshme janë peshuar. Procedura e peshimit siguron që rezultatet të paraqesin shtrirjen e bizneseve në Kosovë, që do të thotë se segmenti i ndërmarrjeve kontribuon me të njëjtën pjesë ose peshë që ka në përgjithësi në Kosovë.

Prandaj, kuotat dhe peshat e mëposhtme u aplikuan për mostrën e anketës me ndërmarrje:

Tabela 7. Mostra dhe peshimi për mostrën e Anketës me Ndërmarrje

| Madhësia e ndërmarrjes | Përqindja e ndërmarrjeve në Kosovë (të dhënat zyrtare) | Anketa (intervistat) | | Pas peshimit ⁴ |
|------------------------|--|----------------------|-------------|---------------------------|
| | | Përqindja | Ndërmarrjet | Përqindja |
| Mikro (1-9) | 93.1% | 45% | 91 | 93.1% |
| Të vogla (10-49) | 5.9% | 35% | 70 | 5.9% |
| Të mesme (50+) | 1% | 20% | 41 | 1% |
| Total | 100% | 100% | 202 | 100% |

⁴ Rezultatet e përgjithshme në grafikë tregohen si të ponderuara/peshuara.

3. Gjetjet e hulumtimit

3.1. Anketa me ekonomi familjare

Ky kapitull i raportit paraqet gjetjet e hulumtimit të mbledhura përmes metodës CATI (Intervistë Telefonike e Asistuar nga Komputeri) me 1,412 individë në Kosovë, duke iu përgjigjur pyetjeve individuale dhe familjare në lidhje me ndikimin socio-ekonomik që ka pasur pandemia koronavirus.

3.1.1 Profili i familjeve dhe karakteristikat demografike

Anketa me ekonomi familjare ka përfaqësim gjinor 50/50, ndërsa 19% e të anketuarve bëjnë pjesë në grupmoshën 18-24 vjeç, 25% në grupmoshën 25-34 vjeç, 21% në grupmoshën 34-44 vjeç, 16% në grupmoshën 45-54 vjeç, 10% në grupmoshën 55-64 vjeç, dhe në fund, 9% janë në grupmoshën 65+.

Figura 1. Gjinia e të anketuarve





Figura 2. Moshë e të anketuarve



Sa i përket shpërndarjes rajonale, mostra është gjithashtu përfaqësuese e popullsisë së Kosovës, ku 10% e të anketuarve janë nga Ferizaji, 11% nga Gjakova, 10% nga Gjlani, 15% nga Mitrovica, 9% nga Peja, 27% nga Prishtina dhe 17% nga Prizreni. Vlen të përmendet se rajoni i Mitrovicës është pak i mbipërfaqësuar sepse ka një nën-mostër të përkatësisë etnike serbe me 96 individë përveç përfaqësimit të përkatësisë etnike shqiptare. Ndërkohë, 45% e të anketuarve banojnë në zona urbane dhe 55% e të anketuarve banojnë në zona rurale.

Figura 3. Vendndodhja e familjeve





Figura 4. Familjet në zonat urbane dhe rurale



Sa i përket nivelit të arsimit, 1% e të anketuarve nuk janë fare të arsimuar; 21% kanë mbaruar arsimin fillor; 47% kanë mbaruar arsimin e mesëm ose ekuivalent; 26% kanë mbaruar arsimin në nivelin universitar (bachelor) ose ekuivalent; dhe 4% kanë përfunduar arsimin pasuniversitar (master ose më të lartë).

Sa i përket përbërjes etnike të të anketuarve, ka të anketuar shqiptarë (92%), serbë (7%) dhe të komuniteteve të tjera jo-shumicë (1%), përfaqësues të njëjtë me përbërjen e vërtetë të popullsisë.

Figura 5. Niveli i arsimit i të anketuarve






Figura 6. Etnia e të anketuarve




Ndërsa, lidhur me statusin civil, 31% e të anketuarve janë beqarë, 63% janë të martuar, 1% janë në bashkëjetesë, 1% të ndarë ose të divorcuar, dhe 4% janë të ve.

Figura 7. Statusi civil i të anketuarve




Anketa gjithashtu eksploroji përbërjen e familjeve. Në këtë drejtim, vetëm 1% e familjeve përbëhen nga një person, 59% e familjeve kanë fëmijë deri në 17 vjeç, 95% të familjeve kanë të rritur nga 18 deri 64 vjeç, dhe 31% e familjeve kanë qytetarë të moshuar nga 65 vjeç e sipër. Sa i përket mesatares së secilës prej këtyre kategorive anëtarësh në familje, një familje ka afërsisht 2.2 fëmijë deri në 17 vjeç, 3.6 anëtarë të rritur dhe 1.4 anëtarë të moshuar. Sidoqoftë, meqenëse përbërja e familjeve ndryshonte dhe kishte disa familje me numër anëtarësh shumë më të lartë se mesatarja; vlen të theksohet se numrat më të përsëritur të anëtarëve të familjes për kategori ishin dy fëmijë, dy të rritur dhe një i moshuar. Ndërsa, 4% e familjeve kishin një grua në familje e cila ishte shtatzënë.

Figura 8. Përbërja e familjes



Sa i përket të ardhurave mujore të familjeve, 21% e familjeve kanë të ardhura të përbashkëta mujore deri në 249 Euro, 19% e familjeve jetojnë me të ardhura mujore nga 250 deri në 299 Euro, 24% kanë të ardhura në mes 400 - 799 Euro, 8% kanë të ardhura familjare mujore nga 800-1,199 Euro, 2% kanë të ardhura familjare mujore nga 1,200-2,000 Euro, dhe 1% jetojnë me të ardhura mujore me më shumë se 2,000 Euro. Ndërkaq, 24% nuk kanë treguar të ardhurat mujore të familjeve të tyre.


Figura 9. Të ardhurat e familjes



Kur u pyetën nëse niveli i të ardhurave të familjes ka ndryshuar si rezultat i pandemisë COVID-19, 3% pohuan se të ardhurat e tyre familjare janë rritur, 49% pohuan se të ardhurat e tyre familjare janë ulur, 44%


pohuan se të ardhurat e tyre familjare nuk kanë ndryshuar, dhe 4% nuk janë të sigurt. Të anketuarit që deklaruan rritje të të ardhurave familjare kanë pësuar mesatarisht një rritje prej 107 Euro në muaj, ndërsa vlera më e përsëritur e deklaruar në këtë grup ishte një rritje prej 30 Eurosh në të ardhurat mujore. Në anën tjetër, pothuajse gjysma e familjeve kanë përjetuar një ulje mesatare prej 406 Eurosh në muaj, ku vlera më e përsëritur e uljes së të ardhurave është 400 Euro në muaj.

Figura 10. Ndryshimi i nivelit të të ardhurave pas pandemisë COVID-19




Duke analizuar këtë çështje sipas gjinisë, 52% e burrave dhe 46% e grave kishin përjetuar ulje të të ardhurave pas pandemisë. Ndërsa, 40% e burrave dhe 48% e grave nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim në të ardhura. Një pjesë e vogël e burrave (4%) dhe grave (3%) kanë pësuar rritje të të ardhurave pas pandemisë COVID-19.

Figura 11. Ndryshimi i nivelit të të ardhurave pas pandemisë COVID-19, sipas gjinisë



Shumica (92%) e familjeve të anketuara nuk kanë asnjë anëtar të familjes me nevoja të veçanta të rënda ose mesatare. Gjithsesi, rreth 4% e tyre kanë anëtarë të familjes me nevoja të veçanta të rënda, dhe 4% të tjerë kanë anëtarë të familjes me nevoja të veçanta mesatare. Mesatarisht, familjet kanë 1.1 anëtarë të familjes që kanë nevoja të veçanta mesatare ose të rënda.

Figura 12. Sa njerëz me nevoja të veçanta jetojnë në familjen tuaj?




| Persona me nevoja të veçanta të rënda | | Persona me nevoja të veçanta mesatare | |
|---------------------------------------|-------|---------------------------------------|-------|
| Mesatarja | Numri | Mesatarja | Numri |
| 1.1 | 56 | 1.1 | 59 |

3.1.2 Vetëdijësimi dhe Informimi rreth COVID-19

Qëllimi i kësaj pjese është të kuptojë se si qytetarët e Kosovës janë duke u informuar në lidhje me virusin COVID-19 përfshirë rreziqet që ai sjell, veprimet e rekomanduara parandaluese dhe strategjitë e përballimit.

Në përgjithësi, qytetarët e Kosovës mbështeten kryesisht në radio, televizion dhe gazetë (89%), internet dhe rrjete sociale (74%) për t'u informuar lidhur me COVID-19. Më rrallë ata i drejtohen njoftimeve publike (20%), faqeve zyrtare të qeverisë (20%), ose familjes dhe miqve të tyre (18%), dhe telefonit (16%) për të informuar veten mbi këtë temë. Ndërsa, nga ato që cekën më shpesh si burime kryesore të informacionit, burimet më të besueshme janë radio, televizioni dhe gazeta (78%) dhe interneti, përfshirë rrjetet e ndryshme sociale (36%).


Figura 13. Burimet kryesore të informacionit dhe burimet më të besueshme të informacionit



Ndërkaq, kur krahasohet sipas përkatësisë etnike, anketa zbulon se shqiptarët e përdorin radion, televizionin dhe gazetën (91%) si burimin e tyre kryesor të informacionit dhe, 81% e tyre i besojnë më shumë këtyre. Për dallim nga ta, serbët i përdorin rrjetet sociale (98%) si burimin e tyre kryesor të informacionit


brenda Kosovës, dhe 75% e tyre i besojnë më së shumti. Më pak serbë deklarojnë radion, televizionin dhe gazetën si burimin kryesor ose më të besueshëm të informacionit.

Figura 14. Burimet kryesore të informacionit dhe burimet më të besueshme të informacionit, sipas përkatësisë etnike




Të rinjtë dhe të rriturit deri në 34 vjeç përdorin internetin dhe rrjetet sociale si burimin e tyre kryesor të informacionit, ndërsa ata nga 35 deri mbi 65 vjeç preferojnë radion, televizionin dhe gazetën.

Figura 15. Burimet kryesore të informacionit, sipas moshës



Megjithatë, sa i përket se cili lloj i mediave është më i besuari për informacion lidhur me COVID-19, radio, televizioni dhe gazeta renditen të parat për të gjitha grupmoshat. Për njerëzit e moshës 18-44 vjeç, interneti dhe rrjetet sociale vijnë në rend të dytë, dhe për njerëzit e moshës 45 vjeç e më lart, ky burim informacioni renditet i dyti, por në një masë shumë më të vogël.

Figura 16. Burimet më të besueshme të informacionit, sipas moshës



Anketa gjithashtu synonte të kuptonte nëse informatat rreth COVID-19 që u shpërndanë nëpër një sërë kanalesh mediatike ishin të dobishme për të anketuarit. Mesatarisht, të anketuarit u pajtuan mjaft shumë se informatat rreth COVID-19 i ndihmuan ata të mbronin veten dhe familjen nga virusi, duke e vlerësuar deklaratën e mëposhtme me 4.3 pikë nga 5.

Figura 17. Niveli i pajtimit me deklaratën: " Informatat rreth COVID-19 më kanë ndihmuar ta mbroj veten dhe familjen nga virusi"



3.1.3 Mësimi në distancë

Një nga masat që qeveria e Kosovës ndërmori gjatë karantinës ishte ofrimi i mësimi në distancë duke e transmetuar atë përmes transmetuesit publik. Në këtë studim ishin 51% të familjeve që kishin fëmijë që shkojnë në shkollë. Prej tyre, 96% e të anketuarve pohuan se fëmijët e tyre ishin në gjendje të ndjekin

mësimin në distancë dhe 4% pohuan se fëmijët në familjet e tyre nuk ishin në gjendje të ndjekin mësimin në distancë.

Figura 18. A ka fëmijë që shkojnë në shkollë në familjen tuaj?






Figura 19. A ishin fëmijët në familje në gjendje të ndiqnin rregullisht mësimin në distancë?



Megjithëse një numër i vogël (4%) i të anketuarve pohuan se fëmijët e tyre humbën mësimin në distancë, mund të ketë pasur një ose disa arsye për këtë. Në këtë drejtim, kur u pyetën cilat ishin arsyet e humbjes së mësimin në distancë, 30% pohuan se më shumë se një fëmijë duhej të përdorte të njëjtën pajisje, 21% u mungonte lidhja në internet, 17% nuk kishin pajisje, 13% nuk kishin sinjal televiziv, 3% nuk dinin se si të qasnin mësimin në distancë, dhe 3% pohuan se një anëtar tjetër i familjes kishte nevojë për pajisje për të punuar nga shtëpia dhe kështu nuk ishin në gjendje t'i huazojnë pajisjet për fëmijët. Ata 23% të cilët cituan arsye të tjera thanë që cilësia e mësimin nuk ishte e mirë, mësuesi nuk e mbajti orën mësimore, fëmija shkon në shkollë speciale për fëmijë me nevoja të veçanta, dhe, në një rast, ata thjesht thanë që nuk ndoqën mësimin në distancë megjithëse kanë pajisjet e nevojshme teknike. Sidoqoftë, duhet të theksohet se mostra e përgjithshme e këtyre përgjigjeve është shumë e vogël, kështu që faktorët që parandalojnë qasjen në mësimin në distancë duhet të analizohen me kujdes më tej.

Në lidhje me cilësinë e arsimit të ofruar përmes mësimin në distancë, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin në një shkallë nga një deri në pesë sa pajtohen se cilësia e arsimit të ofruar përmes mësimin në distancë ishte e mirë. Mesatarisht, të anketuarit pajtoheshin me deklaratën mjaft shumë (3.8/5). Të anketuarit nga rajoni i Gjilanit (4.2/5) janë pajtuar më së shumti dhe të anketuarit nga rajoni i Pejës (3.2/5) janë pajtuar më së paku.


Figura 20. Niveli i pajtimit me deklaratën “Cilësia e arsimit të ofruar përmes mësimëve në distance ishte e cilësisë së lartë”



3.1.4 Punësimi dhe burimet e jetesës


Ky seksion shqyrton se si kanë ndryshuar punësimi dhe jetesa e individëve dhe familjeve pas pandemisë me koronavirus. Të paktën një javë para pandemisë, 54% e burrave dhe 29% e grave kanë punuar në një institucion ose një kompani, ndërsa, 15% e burrave dhe 5% e grave deklarojnë se kanë qenë të vetëpunësuar ose kanë qenë pronarë të bizneseve të tyre. Vetëm rreth 1% e burrave ndihmonin në një biznes familjar pa pagesë. Rreth 7% e burrave dhe 13% e grave ishin të papunë, dhe 3% e burrave dhe 16% e grave ishin punonjës të dekurajuar që nuk po kërkonin punë. Ndërsa, 4% e burrave dhe 6% e grave nuk punonin sepse ishin studentë me kohë të plotë. Kishte edhe pensionistë, nga të cilët 11% ishin burra dhe 9% ishin gra. Edhe pse nuk ishin duke punuar, 3% e burrave dhe 1% e grave ishin përfitues të një skeme të ndihmës sociale publike. Rreth 1% e burrave dhe pothuajse asnjë grua nuk deklaruan se janë të papunë për shkak të gjendjes shëndetësore. Së fundmi, për burrat, përgjegjësia për punët shtëpiake dhe kujdesin familjar nuk paraqiste pengesë në krahasim me 21% të grave.

Figura 21. Statusi i punësimit para COVID-19, sipas gjinisë




Duke krahasuar statusin e punësimit të të anketuarve sipas rajonit, nuk duket se ka ndonjë ndryshim të madh në secilën kategori. Peja dhe Prishtina (48%) kanë përqindjet më të larta të të anketuarve që punojnë për dikë, kompani ose institucion, ndërsa Gjakova (30%) dhe Prizreni (35%) kanë proporcion më të ulët të të anketuarve në këtë lloj punësimi. Sa i përket individëve që nuk punojnë për shkak të punëve shtëpiake dhe kujdesit familjar, Ferizaji (18%) dhe Prizreni (17%) kanë përqindje më të larta të të anketuarve në këtë kategori për të paktën 10 pikë përqindje sesa rajonet e tjera. Sa i përket të papunëve dhe punonjësve të dekurajuar, Gjakova ka proporcion më të madh të të anketuarve me 15% dhe 14% përkatësisht, vijuar nga Peja (13%) dhe Mitrovica (12%) me proporcione të përafërta të punëtorëve të dekurajuar.

Figura 22. Statusi i punësimit para COVID-19, sipas rajonit




Për sa i përket përkatësisë etnike, serbët (78%) kanë një shkallë më të lartë të punësimit në një kompani ose institucion ose që punojnë për dikë sesa shqiptarët (39%). Sidoqoftë, duhet të theksohet se mostra e serbëve ishte e bazuar në "mostër sipas kuotave" ku shumica e të anketuarve që u pajtuan të marrin pjesë në studim punonin në sektorin publik. Pjesa e punëtorëve dhe studentëve të papunë janë më afër në proporcion, është e ngjashme për shqiptarët dhe serbët; ndërsa, pjesa e qytetarëve shqiptarë që kujdesen për familjen, që punojnë në një biznes personal, janë në pension ose janë punëtorë të dekurajuar është më e madhe sesa pjesa e qytetarëve serbë.

Figura 23. Statusi i punësimit para COVID-19, sipas përkatësisë etnike



Krahasuar në bazë të vendbanimit urban apo rural, gjysma e banorëve urban, punojnë për dikë, një kompani ose institucion. Në zonat rurale, kjo pjesë përbën 34% të qytetarëve. Në anën tjetër, në zonat rurale, ka më shumë (13%) njerëz që kujdesen për familjen dhe punët shtëpiake sesa në zonat urbane (7%), si dhe më shumë punonjës të dekurajuar, me një ndryshim prej 4 pikë përqindjeje në krahasim me banorët urban. Ndërsa, në lidhje me statuset e tjera të punësimit, ndryshimet midis zonave urbane dhe rurale janë të vogla.

Figura 24. Statusi i punësimit para COVID-19, sipas zonës së banimit



Nga ata që punojnë në institucione ose ndërmarrje, nuk ka dallime të mëdha rajonale për sa i përket sektorit të punësimit. Pavarësisht kësaj, duhet të theksohet se Gjakova (25%), Gjilani (25%), Peja (25%) dhe Prishtina (26%) kanë rreth një të katërtën e individëve që punojnë në sektorin publik; ndërsa Ferizaji (21%) dhe Prizreni (19%) kanë rreth një të pestën e qytetarëve që punojnë në sektorin publik. Mitrovica ka një pjesë më të madhe të individëve që punojnë në sektorin publik, më shumë se një e treta; megjithatë, duhet të theksohet se kjo mund t'i atribuohet kryesisht një numri të madh të të anketuarve serbë që punojnë në sektorin publik.

Figura 25. Sektori i punësimit, sipas përkatësisë etnike






Figura 26. Sektori i punësimit, sipas rajonit




Krahasuar sipas gjinisë, më shumë se një e treta e grave të anketuara punojnë në sektorin publik, ndërsa rreth një e pesta e burrave punojnë në sektorin publik. Dy të tretat e grave dhe katër të pestat e burrave punojnë në sektorin privat (shih Figurën 27).

Figura 27. Sektori i punësimit, sipas gjinisë



Ka më shumë dallime sipas sektorit të punësimit kur krahasohen grupmoshat e ndryshme. Sa më të rinj të jenë individët, aq më shumë prirjen të punojnë në sektorin privat. Kjo nuk vlen për individët që janë më të vjetër se 65 vjeç, pasi janë vetëm pesë persona prej tyre që janë ende të punësuar dhe mund të jenë afër pensionimit. Të rriturit e rinj që janë 18-24 vjeç që supozohet se janë në fillim të karrierës, punojnë shumë më shumë (92%) në sektorin privat krahasuar me sektorin publik (8%). Grupi tjetër i individëve që janë 25-34 vjeç kanë tendencë ta punojnë në sektorin publik më shumë (24%) sesa grupi i mëparshëm, por edhe këta janë kryesisht të punësuar në sektorin privat (76%). Ndërsa, për ata në grupmoshën 55-64 vjeç ndryshimi midis sektorit publik dhe privat është pothuajse i barabartë.


Figura 28. Sektori i punësimit, sipas moshës



Sa i përket punësimit sipas industrisë, ka dallime më të mëdha gjinore në industri të caktuara. Ka më shumë burra (19%) sesa gra (14%) që punojnë në restorante, kafene, apo hotele. Ndërsa, ka shumë më tepër gra që punojnë në arsim dhe shëndetësi (23%) krahasuar me burrat (6%). Sa i përket industrisë së prodhimit dhe


ndërtimtarisë, burrat (përkatësisht 11% dhe 14%) përsëri përbëjnë një pjesë shumë më të madhe sesa gratë (1% dhe 5%). Gratë janë më të përfaqësuara në sektorin publik, tregti me pakicë dhe tekstil sesa burrat.

Figura 29. Industria e punësimit, sipas gjinisë




Lloji i punësimit, sektori dhe industria e morën për bazë periudhën të paktën një javë para përhapjes së pandemisë COVID-19. Megjithatë, në një pyetje vijuese, të anketuarit u pyetën nëse orët kushtuar punës kanë ndryshuar pas pandemisë dhe, në përgjithësi, 3% thanë se janë rritur, 22% thanë se ju mbetën të njëjta, 2% thanë se orët ju mbetën të njëjta por që ju ishin zvogëluar pagat, 22% thanë se orët u janë zvogëluar por ata janë ende të punësuar, dhe 40% thanë që janë ende të punësuar por aktualisht nuk punojnë fare, ndërsa 8% thanë që kanë humbur vendin e punës.

Figura 30. Ndryshimet në orët kushtuar punës për shkak të pandemisë COVID-19, sipas sektorit të punësimit




Ndikimi i COVID-19 në orët kushtuar punës dallon në bazë të industrisë. Punëtorët më të goditur janë në sektorin e pasurive të patundshme, ndërtimtarisë dhe tekstilit. Kur krahasohen sipas industrisë së punësimit, 7% e të anketuarve në industrinë e tregtisë me shumicë dhe arsimit/shëndetësisë, 5% e të anketuarve në industrinë e shërbimeve profesionale, 4% në prodhim, 3% në sektorin publik dhe 2% në restorante/ kafene/hotel dhe tregti me pakicë deklarojnë se orët e shpenzuara në punë u janë rritur. Në industrinë e bujqësisë, 53% deklarojnë se nuk u kanë ndryshuar orët kushtuar punës që përbën pjesën më të madhe në krahasim me industritë e tjera.

Figura 31. Ndryshimet në orët kushtuar punës për shkak të pandemisë COVID-19, sipas industrisë të punësimit




Për të kuptuar dinamikën e punës dhe mekanizmat e përballjes së institucioneve dhe ndërmarrjeve të ndryshme me punonjësit e tyre, të anketuarit u pyetën nëse ishin detyruar të merrnin pushim për shkak të pandemisë. Nga ata që ishin ende të punësuar pas pandemisë në sektorin publik, 19% morën pushim me pagesë të plotë, 2% pushim të paguar pjesërisht, 2% pushim pa pagesë dhe 58% nuk morën pushim. Ndërsa në sektorin privat, 5% kishin marrë pushim me pagesë të plotë, 7% pushim të paguar pjesërisht, 24% pushim pa pagesë dhe 53% nuk morën pushim. Kishte gjithashtu 3% të të anketuarve që deklaruan se nuk kishin të drejtë pushimi në asnjërin sektor. Megjithatë arsyet për këtë nuk u shqyrtuan më tej përmes anketës, disa nga këto përgjigje mund të vijnë për shkak të llojit të kontratës që kanë punonjësit në secilin sektor.

Figura 32. Detyrimi për marrjen e pushimit (leje) për shkak të pandemisë, sipas sektorit




Ishte gjithashtu e rëndësishme të vlerësohej nëse vendi fizik i punës ka ndryshuar në mes të të anketuarve për të pasqyruar realitetin në Kosovë. Sipas rezultateve të anketës, 27% e të anketuarve ndryshuan vendin fizik të tyre të punës ku tani ata e kryejnë punët në shtëpitë e tyre. Duhet të theksohet se shumë më tepër gra (42%) sesa burra (19%) punojnë nga shtëpia sesa nga vendi i tyre fizik i punës. Ndërsa, 59% e burrave dhe 40% e grave vazhdojnë të punojnë jashtë shtëpisë. Megjithatë, nuk ka dallime gjinore ose ndryshime në vendin tipik të punës për ata, vendi i punës i të cilëve, ishte shtëpia e tyre edhe para pandemisë.

Figura 33. Ndryshimet në vendin (lokacionin) tipik të punës, sipas gjinisë



Sidoqoftë, 90% e të anketuarve që ishin dhe vazhdojnë të jenë të punësuar, që përfaqësojnë pak më shumë se gjysmën e mostrës, janë optimistë për mundësitë e tyre të punësimit pas pandemisë. Vetëm disa (3% dhe 7%) besojnë se nuk do të vazhdojnë të punojnë apo nuk janë të sigurt nëse do të punojnë.


Figura 34. Pritjet në lidhje me mundësinë e punësimit pas pandemisë COVID-19



Sa i përket mënyrës së marrjes së pagës sipas zonës së banimit, 22% e individëve që punojnë në zona urbane krahasuar me 36% të individëve që punojnë në zona rurale i kanë marrë pagat e tyre kesh (para të gatshme)


para COVID-19, dhe rreth 1% dhe 2% përkatësisht kanë marrë një pjesë të pagës kesh dhe një pjesë përmes llogarisë bankare.

Figura 35. Mënyra e marrjes së pagës para COVID-19, sipas zonës së banimit




Ndërsa më e goditura nga informaliteti është industria e ndërtimitarisë ku 83% e të anketuarve deklaruan se marrin pagat e tyre në para të gatshme, përcjellur nga punëtorët në restorante, kafene dhe hotele (47%), në transport dhe komunikim (41%), dhe tekstil dhe veshmbathje (40%). Sektorët më pak informalë në këtë aspekt duket se janë shërbimet profesionale (8%), tregtia me shumicë (8%), arsimi dhe shëndetësia (4%) dhe sektori publik (1%).

Figura 36. Mënyra e marrjes së pagës para COVID-19, sipas industrisë




Burrat duket se janë më të prekur sa i përket punësimit joformal sesa gratë. Përdorësi 58% e burrave dhe 78% e grave janë paguar përmes llogarisë bankare; kishte më shumë burra (36%) sesa gra (15%) të cilët paguheshin me para të gatshme. Vetëm një numër i vogël i burrave (2%) dhe grave (1%) ishin paguar pjesërisht në para dhe pjesërisht përmes llogarisë bankare.

Figura 37. Mënyra e marrjes së pagës para COVID-19, sipas gjinisë




Në mënyrë të ngjashme, shumicës së punonjësve në ndërtimtari (76%) nuk u paguhen kontributet pensionale nga punëdhënësi siç kërkohet me ligj. Sidoqoftë, kjo ndodh edhe në sektorë të tjerë, ku të paktën një të tretës së punonjësve nuk u paguhen kontributet pensionale, përkatësisht, në transport/komunikim (36%), restorante/kafene/hotel (36%) dhe bujqësi (33%). Rreth një të pestës apo të katërtës së punonjësve nuk u paguhen kontributet pensionale në industrinë e tekstitit/veshmbathjes, tregtisë me pakicë dhe prodhimit.

Figura 38. Pagesa e kontributeve pensionale para COVID-19, sipas industrisë



Anketa gjithashtu synonte të kuptonte nëse të anketuarit kishin ndonjë lloj të sigurimit shëndetësor ose ndonjë plan shëndetësor në Kosovë. Shumica e grave (91%) dhe burrave (85%) nuk kanë sigurim shëndetësor. Më shumë burra (7%) sesa gra (4%) kanë sigurim shëndetësor i cili është i mbuluar nga punëdhënësi i tyre. Për më tepër, më shumë burra (4%) sesa gra (2%) paguajnë për sigurimin e tyre shëndetësor. Ndërsa, një pjesë më e vogël e burrave (3%) dhe grave (2%) kanë sigurim shëndetësor i cili është i mbuluar pjesërisht prej tyre dhe pjesërisht nga punëdhënësi i tyre.

Figura 39. Posedimi i sigurimit shëndetësor, sipas gjinisë



Nga ata që janë vetë të punësuar ose të paktën kanë një anëtar të familjes i cili është i punësuar, 48% pohuan se nuk ishin fituesi kryesor i të ardhurave në familje. Sektori i punësimit i fituesit kryesor të të ardhurave në familje shqiptare është 28% në sektorin publik dhe 72% në sektorin privat. Ndërsa, për serbët, 78% është në sektorin publik dhe 22% në sektorin privat.

Figura 40. A jeni fituesi kryesor i të ardhurave në familjen tuaj?, sipas gjinisë






Figura 41. Sektori i punësimit i fituesit kryesor të të ardhurave, sipas përkatësisë etnike




Nga ato familje, ku fituesit kryesor të të ardhurave nuk janë të anketuarit, industrinë e punësimit të fituesve kryesorë janë ndërtimtaria (18%), restorantet, kafenetë, apo hotelet (13%), dhe sektori publik, arsimi dhe shëndetësia (secila nga 12%). Pjesa më e vogël e fituesve kryesorë të të ardhurave janë të punësuar në bujqësi (2%), tekstil/veshmbathje (2%) dhe tregti me shumicë (1%).

Figura 42. Industria e punësimit e fituesit kryesor të të ardhurave



Duke pasur parasysh që punësimi i qytetarëve kishte pësuar ndryshime, ishte me shumë rëndësi të kuptohej nëse të ardhurat e tyre personale nga burime të ndryshme janë ndikuar. U konstatua se 54% e të anketuarve nuk kishin ndonjë ndryshim në të ardhura nga vendi i punës, 39% kishin pësuar rënie, dhe 1% kishin pësuar rritje përmes këtij burimi të fitimit. Sidoqoftë, në përgjithësi, 29% dhe 24% e të anketuarve deklarojnë se të ardhurat e tyre të fituara përmes një pune dhe përmes një biznesi janë zvogëluar. Shumica e të anketuarve nuk marrin të ardhura si mbështetje financiare nga OJQ-të (94%), qeveria (89%), familja (88%), të ardhura nga bujqësia (80%), remitancat (80%), pronat personale, investimet ose kursimet (84%), dhe biznesi familjar (66%). Megjithatë, për ata që kanë të ardhura nga këto burime, ka pasur një ulje prej 5% të të ardhurave nga bujqësia, 4% nga remitancat, 6% nga pronat personale, investimet ose kursimet, dhe 3% nga mbështetja financiare e familjes.


Figura 43. Si pasojë e COVID19, si janë prekur secila nga burimet (të hyrat) e mëparshme PERSONALE?



*Vetëm ata që ishin të punësuar para përhapjes së COVID-19 dhe nuk e kanë humbur punën e tyre

Nga ata që kanë humbur punën e tyre (8%) pas pandemisë, 3% deklaruan se kishin marrë përfitime të papunësisë nga qeveria, dhe 2% se kishin marrë ndihmë financiare nga komunat. Rreth 26% dhe 17% respektivisht presin që të marrin përfitime të papunësisë dhe mbështetje financiare nga qeveria në të ardhmen. Ndërsa, 12% dhe 5% presin të marrin përfitime të papunësisë dhe mbështetje financiare nga komunat e tyre.


Figura 44. A merrni përfitime nga papunësia dhe/ose ndonjë mbështetje financiare nga Qeveria apo komunat që nga përhapja e COVID-19?



*Vetëm ata që kanë humbur punën

Shumica e të anketuarve nuk kanë marrë ndonjë mbështetje materiale nga qeveria (99%), komunat (96%) ose OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare. Sidoqoftë, rreth 4% kanë marrë ushqim dhe 1% kanë marrë produkte higjienike familjare dhe personale nga komunat; ndërsa, 2% kanë marrë ushqim dhe 1% produkte higjienike familjare nga OJQ-të dhe/apo organizatat ndërkombëtare.

Figura 45. A keni marrë ndonjë mbështetje në të mira materiale Qeveria, komunitat, OJQ-të, apo organizatat ndërkombëtare që nga përhapja e COVID-19?




3.1.5 Ndarja e punëve të shtëpisë dhe dinamika shoqërore

Edhe pse përgjegjësitë rreth punëve të shtëpisë janë rritur për të dyja gjinitë si rezultat i COVID-19, orët e dedikuara për pastrim, gatim dhe shërbim të vakteve janë rritur shumë më tepër për gratë. Orët e grave të dedikuara për pastrim janë rritur me 18 pikë përqindjeje më shumë në krahasim me burrat, ndërsa për gatim dhe shërbim të vakteve me 29 pikë përqindjeje më shumë sesa burrat. Ato gjithashtu luajnë, flasin ose u lexojnë fëmijëve dhe kujdesen për fëmijët për 8% dhe 9%, përkatësisht, më shumë se burrat.


Punët e vetme shtëpiake në të cilat burrat kalojnë më shumë kohë sesa gratë janë kujdesi për kafshët shtëpiake dhe aktivitetet bujqësore me 3% dhe 7% dallim në secilën prej tyre.

Figura 46. Si pasojë e COVID-19, a ka ndryshuar numri i orëve dedikuar aktiviteteve të mëposhtme? – sipas gjinisë



*renditur sipas 'është rritur'

Figura 47. Si pasojë e COVID-19, a ka ndryshuar numri i orëve dedikuar aktiviteteve të mëposhtme? – sipas gjinisë




*renditur sipas 'është rritur'

Megjithëkëtë, disa gra deklarojnë se partneri (41%), djemtë (23%) dhe vajzat (21%) e tyre ndihmojnë më shumë në punët e shtëpisë dhe kujdesen për familjen sesa para pandemisë. Sidoqoftë, më shumë burra (56%) deklarojnë se partneret e tyre (d.m.th. gra, përveç nëse në një marrëdhënie me dikë të të njejtës gjini) ndihmojnë më shumë me punët e shtëpisë dhe kujdesin familjar sesa para pandemisë duke theksuar barrën shtesë që gratë marrin përsipër me punët e shtëpisë.⁵

⁵ Përqindjet e zgjedhjeve 'nuk është e aplikueshme' përfshijnë njerëz për të cilët disa nga opsionet nuk aplikohen, për shembull, për individët pa fëmijë ose partnerë, kujdesi për anëtarët e familjes dhe opsionet e kujdesit ndaj fëmijëve nuk aplikohen.


Figura 48. Që nga përhapja e COVID-19, a janë prekur rolet dhe përgjegjësitë tuaja brenda shtëpisë? – sipas gjinisë



3.1.6 Qasja në shërbime bazike dhe Siguria


Ndryshimet në rutinën e përditshme duket se kanë rezultuar në efekte psikologjike për qytetarët në Kosovë. Në këtë drejtim, 25% e burrave dhe 31% e grave deklarojnë se kanë përjetuar personalisht një lloj efekti psikologjik ose emocional për shkak të pandemisë. Ndërsa rreth 2% e burrave dhe 3% e grave kanë efekte në shëndetin e tyre fizik. Pesë përqind e secilës gjini kanë përjetuar sëmundje të një anëtari të familjes, ndërsa nga një përqind e tyre kanë përjetuar vdekjen e një anëtari të familjes.

Figura 49. Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ju personalisht ndonjërin nga të mëposhtmet – sipas gjinisë



Atyre të cilëve u është prekur më së shumti shëndeti mendor, duke përjetuar stres, ankth ose problem tjetër psikologjik janë grupmosha 35-54 vjeç (30%). Sidoqoftë, të gjitha grupmoshat e tjera duket se janë prekur në mënyrë të ngjashme, përveç personave të moshuar (65+) të cilët janë ndikuar pak më pak (21%). Ndërsa personat e moshës 35-44 vjeç dhe ata mbi 65 vjeç kanë pasur shumicën e rasteve të anëtarëve të familjes të sëmurë (nga 7% përkatësisht), njerëzit e moshës 55-64 vjeç kanë përjetuar më së shumti sëmundje fizike (6%) krahasuar me grupmoshat e tjera.


Figura 50 Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ju personalisht ndonjërin nga të mëposhtmet – sipas moshës



Shfaqur vetëm kategorinë që janë përgjigjur me 'po'


Qasja në shërbimet bazike, sociale dhe shëndetësore, transportin publik dhe produktet themelore shëndetësore u hulumtua gjithashtu brenda këtij studimi. Vlen të përmendet se 13% e të gjithë të anketuarve deklarojnë se kanë përjetuar shumë apo ca vështirësi në qasjen e shërbimeve komunale, duke përfshirë energjinë elektrike dhe furnizimin me ujë. Për më tepër, 19% e të anketuarve kanë përjetuar shumë apo ca vështirësi në qasjen e shërbimeve sociale dhe 26% kanë pasur vështirësi qasjen e shërbimeve shëndetësore për veten ose anëtarët e familjes së tyre. Rreth gjysma e të gjithë të anketuarve kanë pasur vështirësi në qasjen e pajisjeve mjekësore për mbrojtje personale dhe produkte ushqimore; rreth një e treta e të anketuarve kanë përjetuar shumë ose pak vështirësi në qasjen e transportit publik, produkteve higjienike dhe sanitare.

Figura 51. Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ndonjë vështirësi të qasni ndonjëherë nga shërbimet bazike të radhitura më poshtë:



Kishte pak dallime gjinore sa i përket qasjes në shërbimet bazike. Nga 13% e të gjithë të anketuarve, kishte 11% burra dhe 12% gra që kishin shumë apo pak vështirësi në qasjen e shërbimeve komunale, duke përfshirë energjinë elektrike dhe furnizimin me ujë. Për më tepër, 25% e burrave të anketuar dhe 27% e grave të anketuara kanë përjetuar vështirësi në marrjen e shërbimeve shëndetësore për veten ose anëtarët e familjes së tyre. Ndërsa, 33% e burrave të anketuar dhe 39% e grave të anketuara kishin vështirësi të kishin qasje në produkte higjienike dhe sanitare. Pavarësisht kësaj, ka pasur dallime më të mëdha gjinore kur bëhet fjalë për ushqimin dhe furnizimet mjekësore për mbrojtje personale. Rreth 46% e burrave dhe 53% e grave kanë pasur vështirësi në sigurimin e ushqimit dhe 51% e burrave dhe 57% e grave kanë pasur vështirësi në sigurimin e pajisjeve mjekësore për mbrojtje personale.


Figura 52. Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ndonjë vështirësi të qasni ndonjërin nga shërbimet bazë të radhitura më poshtë, sipas gjinisë



Shfaqur vetëm kategoritë që janë përgjigjur me 'shumë ose pak vështirësi'

Kur shqyrtojmë qasjen në shërbimet bazike sipas rajonit, më shumë të anketuar nga Gjakova (55%), Mitrovica (58%) dhe Prizreni (56%) pohuan se kishin vështirësi në furnizimin me pajisje mjekësore për mbrojtje personale. Gjakova (55%) dhe Prizreni (58%) kanë deklaruar më shumë për vështirësi në furnizimin me ushqim. Në përgjithësi, këto dy komuna kanë përjetuar nivelet më të larta të vështirësive në të gjitha shërbimet bazike, sociale dhe shëndetësore. Ndërsa, të gjitha komunat kanë pasur nivele të larta vështirësish me furnizimin me produkte higjienike dhe sanitare, ushqimore dhe pajisje mjekësore për mbrojtje personale.


Figura 53. Si pasojë e COVID-19, a keni përjetuar ndonjë vështirësi të qasni ndonjërin nga shërbimet bazë të radhitura më poshtë, sipas rajonit



Shfaqur vetëm kategoritë që janë përgjigjur me 'shumë ose pak vështirësi'

Sa i përket sigurisë financiare të familjeve nëse vazhdojnë masat kufizuese të COVID-19, ekzistojnë një numër veprimesh që të anketuarit do të duhet të ndërmarrin. Nëse krahasohen sipas përkatësisë etnike, rreth 21% e shqiptarëve dhe 3% e serbëve pohuan se mund t'iu duhet që të ndalin marrjen e shërbimeve shëndetësore. Më shumë shqiptarë (43%) sesa serbë (28%) konsiderojnë se do të duhet të marrin një kredi. Për më tepër, 59% e të anketuarve besojnë se do të duhet të kërkojnë ndihmë nga autoritetet lokale, por nga këta vetëm 8% serbë krahasuar me 51% shqiptarë. Të paktën gjysma e shqiptarëve dhe një e treta e serbëve besojnë se do të kenë probleme me pagesën e qirave dhe shërbimeve, do të duhet të kërkojnë ndihmë nga të afërmit dhe miqtë, dhe se do të jetë e vështirë të vazhdojnë me mbulimin e shpenzimeve bazike.

Figura 54. Nëse masat kufizuese lidhur me përhapjen e COVID-19 vazhdojnë, çfarë do të ndodhte me situatën tuaj financiare familjare? – sipas përkatësisë etnike




Shfaqur vetëm kategoritë që janë përgjigjur me 'shumë ose pak vështirësi'

Një çështje tjetër që u shqyrtua është rritja e mundshme e dhunës në familje për shkak të pandemisë. Raportet e policisë tregojnë se gati 650 raste të dhunës në familje janë raportuar në tërë Kosovën në vitin 2020, që paraqet një rritje prej 22% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019.⁶ Për shkak të ndjeshmërisë së temës, pyetjet në lidhje me dhunën në familje u bazuan në perceptimin e rritjes së dhunës në familje dhe nëse të anketuarit e kanë përjetuar vetë. Në përgjithësi, 56% e të gjithë të anketuarve mendojnë se ka rritje të dhunës në familje dhe 64% e tyre dinë ku të kërkojnë ndihmë në rast se ata ose dikush përjetojnë dhunë në familje.

Figura 55. Çështje të ndërlidhura me dhunën në familje


Total (N=1412)



Sipas rajonit, 79% e të anketuarve në Mitrovicë, 62% e të anketuarve në Prishtinë, 60% e të anketuarve në Gjakovë, 59% e të anketuarve në Gjilan, 48% e të anketuarve në Pejë, 44% e të anketuarve në Prizren, dhe 22% e të anketuarve në Ferizaj besojnë se ka rritje të dhunës në familje në Kosovë që nga përhapja e virusit.


⁶ Prishtina Insight. Raportimet e dhunës në familje rriten më 2020. Maj 2020. <https://prishtinainsight.com/reports-of-domestic-violence-increase-in-2020/> E qasur më 21.05.2020

Figura 56. A mendoni se ka rritje të dhunës në familje që nga përhapja e COVID-19?, sipas rajonit



Është e rëndësishme të theksohet se më shumë të anketuar që banojnë në zona urbane sesa në zona rurale e dinë se ku mund të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje në rast të dhunës në familje me një ndryshim prej 10% ndërsa më shumë burra (69%) sesa gra (60%) dinë se ku mund të kërkojnë ndihmë. Dhe, në fund, rreth 84% e serbëve e 63% e shqiptarëve e dinë se ku mund të kërkojnë ndihmë lidhur me dhunën në familje.

Figura 57. A dini se ku mund të kërkon ndihmë dhe mbështetje në rast se dikush përjeton dhunë në familje, sikurse linja telefonike, mbështetje psikologjike dhe policore?, sipas zonës së banimit




3.1.7 Shëndeti seksual dhe riprodhues

Në fund, në anketën e ekonomive familjare, të anketuarit u pyetën nëse ata personalisht kishin vështirësi në qasje të shërbimeve të shëndetit seksual dhe riprodhues, si dhe kontraktivë për veten e tyre, partnerin e tyre ose anëtarët e tjerë të familjes. Nga mostra e përgjithshme, 526 të anketuar dhanë miratimin për t'u përgjigjur për këtë temë.


Shumica dërmuese deklaruan se as ata e as ndonjë nga anëtarët e familjes së tyre nuk kanë pasur nevojë për qasje në shërbimet e shëndetit të nënës (90%), shërbime të planifikimit familjar (90%), shërbime gjinekologjike (87%) ose kontraktivë (84%). Disa të cilët përdorën shërbimet e përmendura, i përdorën ato pa vështirësi, në shumë pak raste të anketuarit ose anëtarët e familjes hasën në vështirësi.

Figura 58. Që nga përhapja e COVID19, a keni përjetuar personalisht vështirësi në qasjen në shërbimet e mëposhtme të shëndetit seksual dhe riprodhues dhe kontraktiv për vetveten, partnerin tuaj ose anëtar tjetër të familjes?



Kur ndahet sipas gjinisë, ekzistojnë ndryshime të vogla në përgjigjet në lidhje me qasjen në shërbime shëndetësore seksuale dhe riprodhuese dhe kontraktivë. Rreth 7% e burrave të anketuar dhe 4% e grave të anketuara pohuan se kishin nevojë për shërbime të planifikimit familjar, por nuk kanë përjetuar vështirësi në qasjen e tyre. Ndërsa, 2% e burrave dhe 3% e grave kanë pasur nevojë dhe kanë hasur në disa vështirësi në qasjen në shërbime gjinekologjike dhe shërbime të tjera të shëndetit seksual dhe riprodhues. Asnjë burrë dhe vetëm disa gra (1%) patën disa vështirësi në qasjen në kontraktivë, përfshirë prezervativët.

Figura 59. Që nga përhapja e COVID19, a keni përjetuar personalisht vështirësi në qasjen në shërbimet e mëposhtme të shëndetit seksual dhe riprodhues dhe kontraceptiv për vetveten, partnerin tuaj ose anëtar tjetër të familjes?



3.2. Anketa me ndërmarrje

Kjo pjesë e raportit paraqet rezultatet e të dhënave të marra nga anketa me 202 biznese në Kosovë. Ndahet në nën-seksione bazuar në pyetëtorin e përdorur për kryerjen e anketës.

3.2.1 Profili i ndërmarrjeve

Në përputhje me shtrirjen e bizneseve në Kosovë, rreth një e treta e ndërmarrjeve janë të vendosura në rajonin e Prishtinës (36%), ndërsa 15% janë të vendosura në rajonin e Prizrenit. Rreth 10% janë në rajone të tjera. Për analizë domethënëse të të dhënave, ndarja sipas rajonit ndahet në bizneset "Prishtinë" dhe "Jo-Prishtinë". Rreth 45% janë ndërmarrje mikro (1-9 të punësuar), ndërsa 35% janë të vogla (10-49 të punësuar) dhe 20% janë të mesme (50+ të punësuar).

Shumica e bizneseve janë ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuar (70%), ndërsa 28% janë biznese individuale. Rreth një e treta e të anketuarve operojnë në treg prej rreth një deri në pesë vjet, ndërsa 59% janë në biznes për më shumë se pesë vjet.

Figura 60. Ndarja e ndërmarrjeve sipas rajonit




Figura 61. Madhësia e ndërmarrjeve




Figura 62. Statusi ligjor i ndërmarrjeve





Figura 63. Vitet në treg të ndërmarrjeve



Tre sektorët, në të cilët, shumica e ndërmarrjeve janë më së shumti aktivë, janë tregtia me pakicë (26%), industria/prodhimi (21%) dhe ndërtimtaria (12%). Shumica e ndërmarrjeve të përfshira në këtë studim nuk eksportojnë mallra ose shërbime (85%).

Figura 64. Ndarja e ndërmarrjeve sipas sektorit





Figura 65. Ndërmarrjet eksportuese




3.2.2 Ndikimi i COVID-19 në ndërmarrje

Ky seksion eksploron se si bizneset në Kosovë janë ndikuar nga pandemia COVID-19. Po ashtu analizon shtrirjen e ndikimit, si dhe mënyrën se si ndikimi manifestohet.

Para përhapjes së pandemisë COVID-19, gati dy në tri ndërmarrje të anketuara përshkruanin performancën e tyre financiare si të mirë (63%). Rreth 28% e konsideruan performancën e tyre financiare para COVID-19 si neutrale dhe vetëm 6% raportuan performancë të dobët.

Sa më e madhe ndërmarrja, aq më e lartë mundësia se ka pasur fitime të mëdha para COVID-19. Ndonëse më shumë biznese të vendosura në Prishtinë raportojnë performancë të mirë financiare (67%), ato të vendosura në rajone të tjera tregojnë pak më shumë larmi me një rezultat më të lartë të bizneseve që ose kanë pasur fitime të mëdha (13%) ose kanë pak humbje apo humbje të mëdha (6% bashkë).


Figura 66. Si do ta përshkruanit performancën financiare të kompanisë suaj para COVID-19?



Rreth dy të tretat e bizneseve përdorin internetin dhe rrjetet sociale si kanal kryesor për të marrë informacione lidhur me rreziqet e ndërlidhura me COVID-19, veprimet e rekomanduara parandaluese si dhe strategjitë e përballimit (64%). Një e treta përdorin radio, televizion dhe gazeta (33%). Bizneset e mesme tregojnë përdorimin më të lartë të internetit dhe rrjeteve sociale si kanali i tyre kryesor për informim.

Duhet të theksohet se asnjë ndërmarrje nuk raportoi komunitetin (përfshirë miqtë dhe familjen), qendrat shëndetësore/mjekët familjarë dhe OJQ-të si kanal kryesor për marrjen e informatave lidhur me COVID-19. Shumë pak përdorin uebfaqet zyrtare të qeverisë (2%).


Figura 67. Cili është burimi juaj kryesor i informacionit në lidhje me COVID-19 (rreziqet, veprimet e rekomanduara parandaluese, strategjitë e përballimit)?



Mbështetja për masat e qeverisë për të mbyllur ose kufizuar aktivitetet e biznesit në mënyrë që të ngadalësojnë përhapjen e COVID-19 duket relativisht e lartë në mesin e bizneseve. Rreth 60% ose mbështesin deri diku ose fuqishëm këto masa, ndërsa vetëm 22% i kundërshtojnë deri diku ose fuqishëm.

Mbështetja e fuqishme është më e dukshme në mesin e ndërmarrjeve të vogla dhe mikro (20% dhe 15% përkatësisht), ndërsa ndërmarrjet e mesme duket të jenë më neutrale në mbështetje të masave (27%) ose në kundërshtim të tyre (22%).


Figura 68. Sa i mbështesni masat aktuale të qeverisë për të mbyllur/kufizuar veprimtarinë e bizneseve në mënyrë që të ngadalësohet përhapja e COVID-19?



Në përgjithësi, gati dy të tretat e ndërmarrjeve të anketuara e vlerësojnë ndikimin e COVID-19 si deri diku negativ (64%), ndërsa 23% e vlerësojnë atë si shumë negativ. Më shumë ndërmarrje të vogla dhe mikro (24% dhe 23% përkatësisht) sesa ndërmarrje të mesme (10%) e vlerësojnë ndikimin si shumë negativ.

Rreth 20% e ndërmarrjeve të mesme vlerësojnë se COVID-19 nuk ka pasur asnjë ndikim në biznesin e tyre, ndërsa vetëm 13% e mikrondërmarrjeve dhe 9% e ndërmarrjeve të vogla deklaruan të njëjtën gjë. Asnjë ndërmarrje nuk deklaroi se COVID-19 kishte pasur ndikim deri diku pozitiv ose shumë pozitiv në biznesin e tyre.


Figura 69. Në përgjithësi, si do ta vlerësonit ndikimin e situatës COVID-19 për biznesin tuaj?



Pastaj, të anketuarit u pyetën për tri arsye se pse situata aktuale ka ndikim negativ ose shumë negativ në biznesin e tyre. Mbi gjysma përmendën mbylljen e biznesit si arsye që COVID-19 ka pasur ndikim negativ ose shumë negativ (58%). Mbyllja e përhershme duket se është veçanërisht problematike për mikro ndërmarrjet (59%) dhe ndërmarrjet e mesme (56%), dhe pak më pak për ndërmarrjet e vogla (44%).

Në anën tjetër, ndërmarrjet e vogla duket se kanë më shumë probleme me pamundësinë për të paguar punonjësit e tyre (34%) sesa ndërmarrjet mikro (19%) ose të mesme (16%). Për më tepër, ndërmarrjet e mesme deklarojnë një rënie më të lartë të shitjeve (22%) sesa ndërmarrjet e vogla (14%) ose mikro (9%).


Figura 70. Arsyet për ndikim shumë negativ dhe negativ



Mbi gjysma e të gjitha ndërmarrjeve të anketuara u detyruan të ndërpresin plotësisht aktivitetin e tyre për shkak të situatës me COVID-19 (56%), ndërsa gati një e treta u detyrua të ndalonte pjesërisht (31%). Vetëm 13% vepronin si zakonisht.

Mikrondërmarrjet dhe ndërmarrjet me operim në treg prej një deri në pesë vjet u detyruan të ndërpresin plotësisht aktivitetin e tyre më shpesh (përkatësisht 57% dhe 56%), sesa ato ndërmarrje që operojnë më shumë se pesë vjet (43%) ose ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (përkatësisht 39% dhe 44%). Sidoqoftë, në të njëjtën kohë më shumë mikrondërmarrje (13%) ishin në gjendje të vazhdojnë të funksionojnë normalisht sesa ndërmarrje të vogla (9%) ose të mesme (12%).


Figura 71. A është dashur që biznesi juaj të ndalojë aktivitetin (qoftë tërësisht apo pjesërisht) për shkak të situatës COVID-19?



Sipas shumicës dërrmuese, masat qeveritare janë arsyt kryesore pse bizneset duhej të ndalonin veprimtarinë e tyre (81%). Kjo duket të vlejë veçanërisht për ndërmarrjet e vogla (91%). Mikrondërmarrjet dhe ndërmarrjet që operojnë prej një deri në pesë vjet duket se ballafaqohen më shumë me mungesën e klientëve ose kërkesës në krahasim me të tjerët (përkatësisht 11% dhe 16%).


Shëndeti dhe siguria e të punësuarve ose pamundësia për të kryer biznes për shkak të natyrës së veprimtarisë përmenden vetëm nga disa.

Figura 72. Cila është arsyeja KRYESORE për shkak të cilës keni ndaluar aktivitetin tuaj? (vetëm ato që kanë ndaluar aktivitetin)



Të dhënat tregojnë më tej se shumica e ndërmarrjeve nuk e ndaluan aktivitetin e tyre përpara se qeveria të vendoste masat e saj (93%). Sidoqoftë, duhet të theksohet se 13% dhe 12% e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme kishin ndaluar aktivitetin e tyre para se të vendoseshin masat, ndërsa vetëm 7% e mikrondërmarrjeve bënë të njëjtën gjë.

Figura 73. A e keni ndaluar aktivitetin e biznesit para se qeveria të shpallte masat kufizuese?




Të anketuarit nga ndërmarrjet u pyetën pastaj edhe nëse ata bënin ndonjë përpjekje për të filluar sërish veprimtarinë e biznesit gjatë kohës së pandemisë/karantinës. Rreth 26% po përpiqeshin të shkurtojnë orarin e punës, ndërsa 19% të pajisnin personelin e tyre me doreza, maska dhe dezinfektues. Rregullimi i distancës së duhur ndërmjet punëtorëve përmendet vetëm nga 16% e të gjitha ndërmarrjeve të anketuara.

Ndërmarrjet e mesme dhe të vogla duket se bënin më shumë përpjekje për të filluar operimin përsëri përmes planifikimit të shkurtimeve të orarit të punës dhe përpjekjes për të rregulluar distancën e duhur midis punëtorëve sesa mikrondërmarrjet. Sidoqoftë, më shumë ndërmarrje mikro duket se planifikonin t'i ofrojnë stafit të tyre pajisje mbrojtëse sesa ndërmarrjet e vogla (19% kundër 16%). Ndërmarrjet me bazë në Prishtinë gjithashtu bëjnë dukshëm më shpesh përpjekje për të zvogëluar orarin e punës (43%) sesa ato me bazë në rajone të tjera (18%).

Duhet të theksohet se shumica e të gjitha ndërmarrjeve nuk merren me asnjë nga përpjekjet e listuara (61%), veçanërisht mikrondërmarrjet dhe ndërmarrjet e vendosura në rajone të tjera nga Prishtina dallohen në këtë aspekt.

Figura 74. Duke marrë parasysh se kjo situatë mund të zgjasë më shumë se një muaj, a po bëni ndonjë përpjekje për të filluar përsëri zhvillimin e biznesit gjatë pandemisë/karantinës?




Vetëm rreth gjysma e të gjitha ndërmarrjeve të anketuara, të cilat duhej të ndalonin veprimtarinë e tyre, po paguajnë pagën e plotë për të gjithë punonjësit (51%). Ndërmarrjet mikro dhe të vogla duket se kanë pak më shumë gjasa të paguajnë pagat e plota (përkatësisht 51% dhe 53%) sesa ndërmarrjet e mesme (45%). Rreth 20% e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme po paguajnë paga të pjesshme për të gjithë punonjësit e tyre, ndërsa vetëm 8% e mikrondërmarrjeve bëjnë të njëjtën gjë.

Një ndryshim i rëndësishëm mund të vërehet midis ndërmarrjeve nga rajone të ndryshme. Vetëm 37% e ndërmarrjeve me bazë në Prishtinë që u detyruan të ndalojnë veprimtarinë e tyre po paguajnë pagë të plotë për stafin e tyre, ndërsa dukshëm më shumë e bëjnë këtë në rajone të tjera (60%).

Në përgjithësi, 40% nuk mendojnë se ndonjë nga veprimet e listuara vlen për ndërmarrjet e tyre. Për më tepër, duhet të theksohet se asnjë ndërmarrje nuk ka deklaruar se ka detyruar punonjësit të marrin pushime vjetore të papaguara ose të paguara.


Figura 75. Që kur ndaluar aktivitetin e biznesit, ju jeni:



Ndonëse shumica e bizneseve vazhdojnë të paguajnë kontribute pensionale për punonjësit e tyre në situatën e COVID-19 (80%), një numër i konsiderueshëm nuk i paguan ato kontribute në të njëjtën mënyrë si përpara përhapjes së pandemisë (20%).


Mikrondërmarrjet (20%) si dhe ato të vendosura në rajonin e Prishtinës (21%) dallohen me një numër më të madh të ndërmarrjeve të cilët nuk paguajnë kontribute pensionale si para COVID-19, kur krahasohen me ndërmarrjet që gjenden në rajone të tjera (15%) ose ndërmarrjet e madhësive më të mëdha (të vogla 17% dhe të mesme 12%).

Figura 76. A vazhdon kompania juaj të paguajë kontribute pensioniale për punonjësit e saj si para përhapjes së COVID - 19?



Vetëm 3% e bizneseve të anketuara, të cilët ndaluan veprimtarinë e tyre, kishin punonjës që dhanë dorëheqje nga puna e tyre. Në dy raste kjo ishte për shkak të pamundësisë për të paguar pagën dhe në dy raste për arsye të tjera.


Figura 77. A ka dhënë dorëheqje nga puna ndonjë punonjës?



Punonjësit e bizneseve që aktualisht janë në funksion kryesisht punojnë në ambientet e biznesit/në terren (82%). Vetëm 12% janë duke punuar nga shtëpia, ndërsa 7% deklarojnë se disa punojnë nga shtëpia dhe të tjerët nga zyra. Më shumë punonjës të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla punojnë nga shtëpia (përkatësisht 9% dhe 11%) sesa ata që janë pjesë e një ndërmarrje të mesme (0%).⁷

⁷ Sidoqoftë, duhet të theksohet se rezultatet në këtë disagregim për ndërmarrjet e mesme dhe për ato me vite në treg nga një deri në pesë vjet janë vetëm indikative për shkak numrit të vogël të rasteve (N = 21 dhe N = 25 përkatësisht).

Figura 78. Cila nga më të mëposhtmet vlen në rastin tuaj?




Tri nga katër bizneset, të cilët ose ndaluan pjesërisht veprimtarinë e tyre ose nuk e ndaluan fare veprimtarinë e tyre, e shohin mungesën e klientëve si problematike duke marrë parasysh situatën aktuale me COVID-19 (75%). Mbi një e treta përmendin mungesën e likuiditetit (36%). Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme luftojnë më pak me këtë çështje në krahasim me mikrobizneset. Ndërmarrjet e vogla duken më të prirura për të parë vështirësi në organizimin e veprimtarive të punës (42%) sesa ndërmarrjet e mesme (29%) ose mikro (28%).

Rezultatet e të dhënave rajonale në këtë drejtim tregojnë bizneset me bazë në rajone të tjera përveç Prishtinës ballafaqohen më shumë me mungesën e klientëve dhe organizimin e punëve sesa ato të vendosura në Prishtinë.⁸

⁸ Ju lutemi vini re se rezultatet për ndërmarrjet e mesme janë vetëm indikative për shkak të numrit të vogël të rasteve, (N=21).

Figura 79. Cila nga më poshtë është problem për kompaninë tuaj duke pasur parasysh situatën aktuale me COVID-19?




Ndërmarrjet të cilat nuk e ndaluan plotësisht veprimtarinë e tyre u pyetën më pas për shqetësimet kryesore nëse situata COVID-19 vazhdon të përhapet gjatë dy ose tre muajve të ardhshëm.

Rreth dy të tretat e bizneseve e konsiderojnë mungesën e klientëve si shqetësimin e tyre kryesor (65%). Mikrondërmarrjet duken më të shqetësuara për këtë çështje, sesa ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Vetëm 10% e shohin si shqetësim vështirësinë në lidhje me pagesat e pagave. Ndërmarrjet e mesme (24%) duken më shumë të shqetësuara në lidhje me vështirësitë me organizimin e punëve sesa ndërmarrjet e vogla (11%) ose mikro (0%).


Kur krahasohen rezultatet e të dhënave midis çështjeve të mësipërme të përmendura për situatën aktuale (me shumë përgjigje, shih Figurën 79 më lart) kundrejt asaj se cili është shqetësimi kryesor i parashikuar për muajt e ardhshëm (me një përgjigje, shih Figurën 80 më poshtë), mund të vërehet se shqetësimi më i madh është mungesa e klientëve.

Figura 80. Nëse COVID-19 vazhdon të përhapet gjatë dy-tre muajve të ardhshëm, cili nga këto do të ishte shqetësimi kryesor për biznesin tuaj?



Bizneset të cilët nuk e ndalën plotësisht funksionimin e tyre u pyetën gjithashtu nëse u është dashur të zvogëlonin fuqinë punëtore për shkak të situatës aktuale dhe shumica e tyre u përgjigjën me jo (89%). Sidoqoftë, sa më e madhe ndërmarrja, aq më e madhe pjesa që ka zvogëluar fuqinë punëtore. Gati 40% e ndërmarrjeve të mesme kanë zvogëluar fuqinë punëtore e për shkak të situatës aktuale (38%).⁹

Figura 81. A është dashur që biznesi juaj të zvogëlojë fuqinë punëtore për shkak të situatës aktuale?




⁹ Ju lutemi vini re se rezultatet për ndërmarrjet e mesme janë vetëm indikative për shkak të numrit të vogël të rasteve, (N=21).

Ndërmarrjet që u detyruan të ndalonin veprimtarinë e tyre (N=111) u pyetën pastaj për çështjet që kanë çuar në mbylljen e biznesit. Duhet të theksohet këtu se "masat qeveritare" nuk ishin një alternativë për t'u zgjedhur në pyetësor për këtë pyetje; megjithatë, 51% e deklaruan këtë çështje nën opsionin e përgjigjes "tjetër" në përgjigje.

Pas zbatimit të masave qeveritare, gati një e treta e secilës përmendin mungesën e klientëve dhe vështirësitë e pagimit të pagave të stafit të tyre (përkatësisht 30% dhe 31%) si arsye pse atyre u duhej të mbyllnin biznesin e tyre. Rreth 20% shprehen se kanë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve tatimore. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të mbyllura duket se kanë më shpesh vështirësi në lidhje me pagesat e pagave sesa ndërmarrjet mikro.¹⁰

Figura 82. Cilat nga çështjet e mëposhtme ju detyruan të mbyllni aktivitetin e biznesit? (Pyetje me shumë përgjigje)




Kur u pyetën për arsyen kryesore (një përgjigje) e cila i detyroi ndërmarrjet të ndërpresin veprimarinë e tyre masat e qeverisë (51%), mungesa e klientëve (24%) dhe vështirësitë për të paguar pagat (16%) dallohen si tri arsyet kryesore sipas kësaj radhitjeje.

¹⁰ Please note that the results for medium businesses is indicative only due to the small number of cases, (N=21)

Masat që lidhen me furnizimin me pajisje të sigurisë për stafin e tyre (d.m.th. doreza, maska dhe dezinfektues) ndërmerren më së shpeshti nga ato biznese që vetëm pjesërisht ose aspak nuk e kanë ndaluar punën e tyre (88%).

Rreth 15% lejojnë që punonjësit e tyre të punojnë nga shtëpia. Vetëm disa morën masa që lidhen me përdorimin e ditëve të pushimit vjetor ose pagimin e pagave më të ulta (6% secila).


Figura 83. A është dashur që biznesi juaj të marrë masa të tjera për punonjësit? Cilat nga të mëposhtmet vlen?



Bizneset të cilët janë akoma funksionale (ose pjesërisht funksionale) u pyetën më tej nëse të ardhurat, shpenzimet, shitjet dhe inventarët e tyre janë ulur, rritur apo kanë mbetur të njëjta që nga përhapja e COVID-19.


Shumica raportuan ulje të të ardhurave (63%), shitjeve (56%) por edhe shpenzimeve (56%). Inventari nuk u ndikua për 61% të bizneseve të anketuara që janë akoma duke vepruar (ose pjesërisht duke vepruar).

Figura 84. Ndikimi në të ardhura, shpenzime, shitje dhe inventar



Marrja e një kredie për të përballuar efektet aktuale të COVID-19 nuk duket që konsiderohet nga ndërmarrjet e anketuara. Vetëm 28% deklaruan se po mendojnë të marrin një kredi. Bizneset e vogla dhe bizneset me veprim për më shumë se pesë vjet duket se kanë më shumë gjasa të konsiderojnë marrjen e një kredie se të tjerët.


Figura 85. A po konsideron biznesi juaj të marrë një kredi për t'u përballuar me efektet aktuale të situatës me COVID-19?



Bizneset që deklaruan se nuk konsiderojnë marrjen e një kredie u pyetën për arsyet përkatëse. Normat e pafavorshme të interesit janë arsye të më së shpeshti përmenden nga ndërmarrjet e vogla dhe të vogla (përkatësisht 38% dhe 40%), ndërsa shumica e ndërmarrjeve të mesme nuk e shohin nevojën për një kredi (50%).

Një numër i konsiderueshëm i mikrondërmarrjeve (20%) mendojnë se nuk do të mund të merrnin një kredi për shkak të rrezikut të lartë të pamundësisë për ta paguar atë, ndërsa rreth 18% nuk e shohin nevojën për një kredi dhe nuk presin që situata e tanishme të zgjasë.

Figura 86. Nëse jo, cila është arsyeja kryesore?




3.2.3 Pritjet për të ardhmen

Kjo pjesë përfshinë pyetje, ndër të tjera, në lidhje me të ardhmen e bizneseve gjatë vazhdimit të pandemisë, masave qeveritare dhe ndikimit të tyre, si dhe sugjerime se si bizneset mund të përkrahen më mirë në situatën aktuale.

Kur u pyetën se edhe sa gjatë bizneset mund të përballojnë situatën aktuale, më shumë se një në tre nuk e kishin një përgjigje (36%). Pasiguria duket veçanërisht e lartë në mesin e ndërmarrjeve të mesme (46%) dhe ndërmarrjeve me bazë në rajonin e Prishtinës (52%). Gati po aq vlerësojnë se bizneset e tyre mund të përballojnë situatën për edhe një deri në dy muaj më shumë (35%). Rreth 11% vlerësojnë se mund ta përballojnë situatën edhe më pak se një muaj. Ndërmarrjet e mesme duken më të prira se të tjerat të jenë në gjendje të përballojnë situatën për më shumë se gjashtë muaj.

Figura 87. Duke marrë parasysh të gjitha, edhe sa kohë mendoni se biznesi juaj mund ta përballojë këtë situatë?




Kur u pyetën se çfarë ndikimi mund të kenë një sërë masash qeveritare në ndërmarrjet e anketuara, mbi 90% nuk shihnin asnjë ndikim në lidhje me pesë nga shtatë masat e listuara.¹¹

Vetëm për sa i përket ndihmës për bizneset në mbulimin e kostove operacionale, si dhe shtyrjen e deklaratave tatimore nga ATK, një numër ndërmarrjesh që vlen të përmendet menduan se do të kishte ndikim të vogël (10% secila) ose ndikim mesatar (6% dhe 12% respektivisht). Zbërthimi i mëtejshëm i këtyre rezultateve sipas madhësisë së biznesit tregoi se ndërmarrjet e vogla vlerësojnë ndikim pak më të lartë në lidhje me dy masat e lartpërmendura.

Të dhënat treguan se ndërmarrjet në përgjithësi duket se mendojnë se masat e listuara nuk janë efektive për nevojat e tyre.

Figura 88. Sa kanë ndikuar masat e mëposhtme qeveritare në biznesin tuaj?




¹¹ Ju lutemi vini re se 85% e ndërmarrjeve të anketuara nuk merren me eksportimin e mallrave apo shërbimeve. Prandaj, masat në lidhje me këto çështje mund të mos jenë të rëndësishme/zbatueshme për një numër të madh të tyre që morën pjesë në këtë anketë. E njëjta vlen edhe për masat në lidhje me bujqësinë, pasi vetëm 2% e ndërmarrjeve të anketuara janë pjesë e këtij sektori.

Kur u pyetën për sugjerimet ndaj qeverisë mbi masat që mund të ndihmonin bizneset e të anketuarve rreth një në katër nuk kishin një sugjerim (23%). Gati aq sugjeruan ndihma financiare (21%) ose lehtësime/lirime nga detyrimet tatimore (18%) në vend që t'i vetëm t'i shtyejnë ato.


Ndihma financiare është më së shumti e nevojshme nga mikrondërmarrjet (22%) dhe më pak për ndërmarrjet e vogla (11%) ose të mesme (7%). Ndërmarrjet e vogla më së shpeshti sugjerojnë lehtësime/lirime nga detyrimet tatimore (17%), si dhe kredi me interes të ulët ose kredi pa interes (14%). Kjo e fundit përmendet gjithashtu nga 17% e ndërmarrjeve të mesme.

Figura 89. Cili do të ishte sugjerimi juaj për qeverinë për masat që mund të ndihmojnë llojin e biznesit tuaj për t'u përballur me situatën?




Shumica nuk kishin ndonjë sugjerim për organizatat ndërkombëtare në lidhje me masat që mund të ndihmojnë bizneset në Kosovë që të merren me situatën aktuale (56%). Rreth 39% mendonin se organizatat ndërkombëtare duhet të ndihmojnë përmes ndihmës financiare. Të anketuarit nga ndërmarrjet e mesme dallohen në këtë aspekt ku 71% e tyre nuk kanë sugjerime dhe vetëm 17% mendojnë se ndihma financiare do të ndihmonte biznesin e tyre.

Figura 90. Cili do të ishte sugjerimi juaj për organizatat ndërkombëtare për masat që mund të ndihmojnë llojin e biznesit tuaj për t'u përballur me situatën?




Pak më shumë se një e treta e bizneseve kishin plan për investime para situatës COVID-19 (35%). Sa më e madhe ndërmarrja, aq më shumë kishte mundësi se ishin planifikuar investime. Pothuajse gjysma e të gjitha ndërmarrjeve të mesme kishin planifikuar të investojnë para përhapjes së pandemisë (46%).

Figura 91. A keni pasur ndonjë plan për investime, përpara situatës me COVID-19?



Bizneset që kishin planifikuar të bënin investime para gjendjes meCOVID-19 (N=70) u pyetën pastaj nëse këto plane kanë ndryshuar. Të dhënat zbuluan se shumica e të anketuarve kanë ndryshuar planet e tyre dhe tani nuk po mendojnë të bëjnë ndonjë investim (84%) për shkak të situatës aktuale. Është interesante se mikrondërmarrjet (13%) dhe bizneset në operim nga një deri në pesë vjet (18%) ndryshuan planet e tyre, megjithatë, me qëllim që të bëjnë më shumë investime tani.¹²


Figura 92. A kanë ndryshuar këto plane për shkak të situatës? (Vetëm ata që kanë pasur plane investimi)



¹² Ju lutemi vini re se këto rezultate për ndërmarrjet e mesme dhe ato të vendosura në Prishtinë janë indikative vetëm për shkak të numrit të vogël të rasteve (N = 19 dhe N = 21 përkatësisht).


Pothuajse asnjë nga ndërmarrjet e anketuara nuk shohin mundësi të reja biznesi në lidhje me COVID-19. Vetëm 4% që është e barabartë me nëntë biznese deklarojnë se shohin mundësi të reja për veprimtarinë e tyre.

Figura 93. A shihni ndonjë mundësi të re për biznesin tuaj për shkak të COVID-19?



Në fund, bizneset u pyetën të vlerësojnë se kur mendojnë se Kosova do të kthehet në jetën normale si para përhapjes së COVID-19. Gati 40% nuk ishin në gjendje të japin përgjigje për këtë pyetje (39%) duke treguar që shumë prej tyre ndjehen të pasigurt për të ardhmen. Rreth 27% mendojnë që do të zgjasë më shumë se 6 muaj, ndërsa 15% vlerësojnë se do të zgjasë 3-6 muaj. Pasiguria për të ardhmen duket se është më e theksuar në mes të ndërmarrjeve mikro (40%) dhe atyre me bazë në rajonin e Prishtinës (36%). Sa më e madhe ndërmarrja, aq më i lartë është proporcioni i atyre që besojnë se kjo situatë do të marrë më shumë se 6 muaj kohë.

Figura 94. Në përgjithësi, kur mendoni se Kosova do të rikthehet në jetën normale?



4. Përfundime

4.1. Përfundime

Ky studim kishte për qëllim të kuptonte sfidat dhe nevojat e ekonomive familjare dhe të ndërmarrjeve në Kosovë gjatë pandemisë me COVID-19. Duke marrë parasysh gjetjet kryesore të këtij hulumtimi, janë nxjerrë përfundimet e mëposhtme.

PËRFUNDIMET E ANKETËS ME EKONOMI FAMILJARE

Në vlerësimin e ndikimit të COVID-19 tek familjet në Kosovë, të dhënat zbuluan se mësimi në distancë për fëmijët në Kosovë nuk ishte ndonjë problem i madh, meqë gati të gjithë ishin në gjendje të ndiqnin mësimet rregullisht (96%). Çështjet në lidhje me papunësinë, efektet në shëndetin psikologjik, mendor ose emocional, si dhe qasja në nevoja bazike ishin megjithatë të dukshme.

Para se të shfaqej situata me COVID-19, shumica e burrave (54%) dhe 29% e grave kanë qenë të punësuar dhe duke punuar. Pas shfaqjes së pandemisë COVID-19 në Kosovë, rreth 40% e atyre që ishin të punësuar nuk e humbën punën e tyre por nuk po punonin fare gjatë realizimit të intervistave. Vetëm 8% e humbën punën për shkak të përhapjes së COVID-19. Sidoqoftë, brenda këtyre 8%, humbja e vendeve të punës në sektorin e ndërtimitarisë (23%) si dhe në sektorin e mikpritjes (14%) ishte e konsiderueshme. Kjo është problematike për faktin se sektori i ndërtimitarisë, si dhe sektori i mikpritjes, punësojnë shumicën e fituesve kryesorë të të ardhurave të familjes (përkatësisht 18% dhe 13%). Shumica e të anketuarve, të cilët humbën vendin e punës, nuk morën mbështetje financiare, përfitime papunësie ose ndihma materiale nga qeveria, komunitat ose OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare.

Më shumë gra të anketuara (49%) sesa burra të anketuar (19%) punonin nga shtëpia. Kjo mund të ketë ndodhur për shkak të rritjes së madhe të punëve për gratë brenda familjes për shkak të COVID-19. Ndonëse punët shtëpiake janë rritur për të dyja gjinitë si rezultat i pandemisë, orët e dedikuara për punë të shtëpisë dhe kujdesit ndaj familjes janë rritur dukshëm më shumë për gratë sesa burrat.

Si rezultat i COVID-19, gati një e treta e të anketuarve panë efekte në shëndetin e tyre psikologjik, mendor ose emocional (28%). Pak më shumë gra sesa burra raportuan efekte të tilla (31% kundrejt 25%), banorët e dy rajoneve të Gjakovës dhe Prizrenit gjithashtu duket të jenë ndikuar më tepër (përkatësisht 53% dhe 46%). Për më tepër, duhet të theksohet se mbi gjysma e të anketuarve mendojnë se ka rritje të dhunës në familje që nga përhapja e COVID-19 (56%), ndërsa mbi një e treta nuk dinin se ku të kërkonin ndihmë nëse do të përjetonin ose shihnin raste të tilla (35%).

Çështje të rëndësishme, si rezultat i COVID-19 në Kosovë, lidhen gjithashtu me vështirësitë e hasura në qasjen e shërbimeve bazike me ç'rast 44% e të anketuarve raportojnë pak vështirësi në blerjen e produkteve ushqimore dhe 6% raportojnë vështirësi të mëdha. Mbi gjysma e të gjithë të anketuarve gjithashtu raportojnë vështirësi në sigurimin e pajisjeve mjekësore për mbrojtje personale (49% padhe 5% vështirësi të mëdha). Mbi një e treta mundohet me sigurimin e produkteve higjienike e sanitare. Nëse masat kufizuese që lidhen me përhapjen e COVID-19 vazhdojnë, mbi gjysma e të gjithë të anketuarve kanë frikë se do të ishte e vështirë të mbulonin shpenzimet themelore siç janë ushqimi dhe produktet higjienike (59%). Duhet theksuar se të anketuarit shqiptarë duken dukshëm më të brengosur për implikimet e zgjatjes së masave kufizuese për të ardhmen sesa të anketuarit serbë.

PËRFUNDIMET E ANKETËS ME NDËRMARRJE

Ndikimi i COVID-19 në ndërmarrjet në Kosovë është gjithashtu i konsiderueshëm. Kjo veçanërisht ka të bëjë me efektet negative siç janë mbyllja e ndërmarrjeve, mungesa e klientëve dhe pamundësia për të paguar punonjësit.

Aspekti më i rëndë i ndikimit shfaqet përmes mbylljes së më shumë se gjysmës së ndërmarrjeve të anketuara (56%). Gati një e treta u detyruan të ndalonin pjesërisht veprimtarinë e tyre (31%) dhe vetëm 13% po

funksionon si zakonisht. Mikro-ndërmarrje si dhe ndërmarrjet e reja (ato që janë në treg nga një deri në pesë vjet) duket se janë veçanërisht më të prekura në këtë drejtim duke u detyruar më shpesh të ndërpresin plotësisht veprimtarinë e tyre (përkatësisht 57% dhe 56%). Arsyeja kryesore që i detyronte ndërmarrjet të ndalonin veprimtarinë e tyre ishin masat e qeverisë (81%). Megjithatë, mbështetja për masat qeverisë, për të mbyllur ose kufizuar aktivitetet e ndërmarrjeve në mënyrë që të ngadalësojnë përhapjen e COVID-19, duket relativisht e lartë mes ndërmarrjeve. Rreth 60% e tyre i mbështesin deri diku ose fuqishëm këto masa.

Për më tepër, ndërmarrjet që nuk ndaluan veprimtarinë e tyre, ose e ndaluan atë vetëm pjesërisht, kryesisht e shohin mungesën e klientëve si më problematike duke marrë parasysh situatën aktuale COVID-19 (75%). Mbi një e treta e mikrondërmarrjeve përmendën mungesën e likuiditetit (38%) si problem. Gati 40% e ndërmarrjeve të mesme zvogëluan fuqinë e tyre punëtore për shkak të situatës aktuale. Masat që lidhen me sigurimin e pajisjeve mbrojtëse personale për stafin e tyre (d.m.th. doreza, maska dhe dezinfektues) janë ndërmarrë më së shpeshti nga ato ndërmarrje që është dashur të ndalin funksionimin e tyre vetëm pjesërisht ose fare (88%).

Kur u pyetën se edhe sa gjatë bizneset mund të përballojnë situatën aktuale, më shumë se një në tri nuk kishin përgjigje (36%). Pasiguria në lidhje me këtë duket veçanërisht e lartë në mesin e ndërmarrjeve të mesme (46%) dhe ndërmarrjeve që veprojnë në rajonin e Prishtinës (52%). Pothuajse po aq prej tyre vlerësojnë se ndërmarrja e tyre mund të përballojë situatën vetëm edhe për një deri në dy muaj (35%). Në një nivel më të përgjithshëm, pothuajse 40% nuk ishin në gjendje të vlerësojnë se kur jeta në Kosovë mund të kthehet në normalitet.

Pak më shumë se një e treta e ndërmarrjeve kishin plane për investime para situatës COVID-19 (35%), shumica e tyre tani kanë ndryshuar planet e tyre dhe po tërhiqen nga investimet (84%) për shkak të situatës aktuale. Kur u pyetën për të dhënë sugjerime kundrejt qeverisë rreth masave që mund të ndihmojnë ndërmarrjet e tyre, ndihma financiare dhe lirimi nga detyrimet tatimore përmenden më së shpeshti.